

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7592 E mërkurë 18 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Samiti Trump - Putin u zhvillua në Helsinkë, si metropoli tradicional i ngjarjeve të tilla madhore e ndoshta dhe për qetësinë e freskinë e tij, sidomos këtë ...
Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE

Samit pa frymën e Helsinkit



Opinion

Ditës

Edhe pse nuk ka një studim të mirëfilltë, në tetor 1996, numri i kryefamiljarëve që në periudhën prill 1994-shtator 1996 kishin shitur shtëpitë për ...
Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI

Punësimi i kumarit



Komisioneri i BE: Vazhdoni vettingun

Hahn: Nuk ka kushte shtesë për në BE.
Rama: Bashkëpunojmë me partitë e opozitës

Kryemadhi: Tryezat me simbolet e Europës s'janë hap para. Bylykbashi: Hahn do habitet

DARINA TANUSHI

Qeveria shqiptare nisi dje në prani të komisionerit për Zgjerimin, Johannes Hahn fazën përgatitore të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian. Kryeministri Edi Rama dhe komisioneri evropian për Zgjerimin,...

Në faqen 3

POLICIA E SHTETIT PUBLIKON DOKUMENTACIONIN, PERZGJIDHEN 150 KANDIDATE

AKADEMIA E POLICISE, JA KRITERET PER TE APLIKUAR

Nuk pranohen personat e larguar nga shërbimi civil. Afati, konkurrimi do të zhvillohet nga 20 korriku në 20 shtator. Ja penalitetet që ju përjashtojnë



(Në foto) Policë (foto ilustruese)

Në faqen 6

GJOBAT

PS-PD, debat në Komisionin e Sigurisë për Kodin Rrugor

Në faqen 4

PERPLASJA

Dëftesat, Vokshi: Qeveria mashtroi. Lindita Nikolla: Do t'ju padis!

Në faqen 5

KOMPENSIMI

Pronat në Korçë, ATP-ja merr në shqyrtim 10 mijë dosje të reja


Në faqen 10-11

QENDRIMI I EKSPERTIT

Arkitecti holandez: Çfarë mendoj për projektet e reja në të gjithë Shqipërinë

Në faqen 18-19

DETAJET HETIMORE



Vrasja e çiftit në Shkodër, autori priti viktimat 1 orë para pallatit

Në faqen 7



Rrëfëhet këngëtari: Skena, qëllimi im në jetë për të qenë argëtues

Alban Ramosaj: Koha mes muzikës dhe modelingut

Në brendësi: Oriola Marashi "çmend" pushuesit, del me bikini minimale

Nga EGLA XHEMALI

Ai është një nga këngëtarët më të dashur dhe më simpatik në Shqipëri. Bëhet fjalë për Alban Ramosajn, i cili këtë herë vjen në një rrëfim ndryshe për suplementin "Summer Pages" të "Gazeta Shqiptare". Kjo verë



e ka gjetur këngëtarin të impenjuar me muzikën, si dhe me modelingun që i rrëmben një pjesë të mirë të kohës. Albani na pohon se është siguri e madhe shpirtërore kur ndan me motrën të njëjtin pasion, pasi në këtë mënyrë mbështesin njëri-tjetrin ...

Suplement

INTEGRIMI REAGIMET

Kryetarja e LSI reagon për vizitën e Hahn: Komisionerin e kanë gënjer

Kryemadhi: Rama shpalosi si arritje të qeverisë së tij kopjen e Klajda Gjoshës

"Tryezat me simbolet europiane s'janë hap para"

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi deklaroi dje se komisionerin për zëzërimin Johannes Hahn e kanë gënjer. Duke iu referuar tryezës së përbashkët të Hhan me qeverinë, Kryemadhi u shpreh përmes një reagimi në "Facebook": "Fjalët e bukura nuk të çojnë gjëkund, aq më pak në BE! As tryezat e stiluara me simbolet europiane dhe që i kushtojnë shtrenjtë buxhetit të Shqipërisë, nuk janë hap përpara për plotësimin e kushteve të rrepta, që na kanë vënë partnerët tanë në Bruksel". Sipas Kryemadhit, "e gjithë strategjia që kryeministri shpalosi sot (dje) si arritje të qeverisë së tij nuk është gjë tjetër vetëm një kopje e strategjisë që ministria Klajda Gjoshë ia ka kërkuar për ta zbatuar, por që s'e bëri kurrë. Deri më sot, kur i vënë me shpatulla pas muri u detyrua të pranojë dhe zbatojë ato që duhet të kishte bërë prej vitesh e që i ka pasur në tryezën e punës. Paaftësia, arroganca dhe korrupsioni, përfshirja në trafikë dhe lënia e Shqipërisë jashtë hapjes së negociatave nuk mund të ndreqen me kopjet që i merr nga ish-ministria e Integrimit. Asnjë deklaratë e thënë në anglishte të qartë, asnjë kompliment apo lajkë e bërë për ndërkombëtarët e Brukselit apo ata që janë në ikje e sipër nuk e zhbën dot trafikun e drogës, përfshirjen në krimin e organizuar, shkatërrimin e administratës publike dhe ngecjen në reformën në drejtësi", theksoi kryetarja e LSI-së. "Ndaj -shtoi ajo më tej - çdo përpjekje për shou me ngjyra e ndriçim artificial është thjesht i dalë mode si metodë për të gënjer shqiptarët, që sot më shumë se kurrë e kanë kuptuar dhe ndjerë paaftësinë, makutërinë, banditizmin dhe arrogancën e veshur me rroba të bukura të një qeverie në ikje e sipër. Vetëm një qeverisje e re, pa Ramën

kryeministër, e vendosur për të larguar bandat nga bashkëqeverisja do të mund të bëjë atë që të gjithë shqiptarët presin plotësimin e kushteve për të qenë sa më

shpejt pjesë e familjes europiane", theksoi Kryemadhi. E në një shënim të fundit, kryetarja e LSI-së u shpreh: "E kanë gënjer kaq shumë komisionerin Hahn sa nuk

i kanë thënë që për studentët e magistraturës numrin e tyre e vendos KLP dhe KLGJ, të cilat ky kryeministri që e pret nuk ka për t'i ngritur kurrë".



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi

PRESIDENTJA KROATE

Një javë pasi ndoqi finalen e Botërorit ku Kroacia u rendit në vendin e dytë, Presidentja e Kroacisë Kolinda Grabar-Kitarovi do të zhvillojë një vizitë zyrtare në Tiranë. Mësohet se gjatë vizitës, ajo do të takohet me krerët e shtetit shqiptar, Presidentin Ilir Meta dhe kryeministrin Edi Rama. Ndërsa këtë të enjte pritet të mbajë edhe një fjalim në parlamentin shqiptar.



Votimi për ligjin e magistraturës

Vasili vë në diskutim komisionerin:

I ngatërroi edhe Hahn numrat e votave

Kreu i grupi parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili ka vënë në diskutim deklaratat e komisionerit evropian për zgjerim, Johannes Hahn gjatë takimit me kabinetin qeveritar dhe kryeministrin Edi Rama. Ai tha se Hahn "ia futi kot" për shkollën e magistraturës kur tha se duhen 2/3 e votave, pasi duhen 3/5 e votave aq sa ka vendosur sipas tij, Hahn i parë më 21-22 korrik. "Cilin Hahn të besojmë, atë që miratoi reformën në drejtësi të 21-22 korrikut, apo këtë që foli sot. Më mirë asnjërin prej të dyve. Pasi ky Hahn i dytë që u shfaq sot, ia futi kot fare edhe për shkollën e magistraturës dhe tha se duhen 2/3 e votave në parlament. Në fakt, nuk duhen fare 2/3 e votave, por 3/5 e votave, aq sa ka vendosur Hahn i parë në 21-22 korrik. Por ngaqë ka qenë gjithë ditën me shkollëpakun sot dhe ka dëgjuar e dëgjon vetëm atë, i ngatërroi edhe Hahn numrat e votave, ndaj sqaroheni mor aman sa la nam", shkroi dje Vasili.

Deputeti i PD-së: Në vend të një bisede me komisionerin

Bylykbashi: Reforma në drejtësi ka dalë nga shinat, Hahn do të vazhdojë të habitet

Deputeti demokrat, Doerd Bylykbashi shprehur dje disa nga shqetësimet e tij, në vend të bisedës së munguar me komisionerin e zgjerimit, Johannes Hahn. "Komisioneri Hahn u shpreh se vetingu po ecte mirë, por tha edhe se do të ishte dizastër, nëse për shkak të vetingut, shqiptarët të mbeteshin pa gjyqtarë. Unë nuk pata rastin ta takoj, por disa gjëra po i them këtu. Ka të drejtë, dizastër? epokal është! Dhe, në fakt, po ndodh! Nuk është hipotetik. Sot nuk kemi Gjykatë Kushtetuese, por vetëm një anëtar të saj nga nëntë që duhet të kishite", u shpreh Bylykbashi përmes një postimi në "Facebook". Sipas tij, deri në fundjavë nuk është çudi që

të mbeten vetëm 5. Sipas tij, vetingu nuk është reformë, sepse vetingu vetëm spastron. "Komisioneri Hahn tha se u duhet hapur rruga ndryshimeve të ligjit për Shkollën e Magistraturës që të zgjidhet ngërçi. Përsëri e kanë gënjer! Regjistrimi në shkollë i studentëve të rinj nuk është reformë, është rutinë dhe nuk zgjidh gabimet apo fajet e rënda konceptuale të reformës. Boshllëku që komisioneri e quajti dizastër, nuk mund të mbushet dot nga rekrutimi i studentëve. Duhet tri vite që ata që do të rekrutohen të mund të quhen gjyqtarë e prokurorë, por do të jenë pa



eksperiencë. E vetmja eksperiencë do të jetë ajo që do t'i japë linja politike që kontrollon sot Magistraturën. Komisioneri u çudit se pse duhet të miratohet me 3/5 një

ligj për një shkollë, qoftë kjo e Magistraturës. Ka shumë të drejtë të habitet. Para dy vitesh duhej shumicë e thjeshtë, por ata që e gënjen, nuk i thonë kurrë të vërtetën", vijoi sqarimet e tij Bylykbashi. Ai kujtoi se opozita e kundërshtoi faktin që Shkolla e Magistraturës të futej në Kushtetutë, sepse nuk është organ kushtetues dhe nëse do të lindte nevoja për ndryshime, do të bllokohej meqë do të nevojiteshin 3/5. Duke akuzuar Ramën për kapjen e drejtësisë, Bylykbashi vijoi komentin e tij: "Nuk kemi Gjykatë Kushtetuese. Nuk kemi Gjykatë të Lartë.

Nuk kemi Prokuror të Përgjithshëm, siç kërkon Kushtetuta. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është paralizuar nga vetingu dhe pa të nuk kemi kandidatë për në Gjykatë Kushtetuese dhe Inspektor të Lartë të Drejtësisë, që do të hetojë shkeljet e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Pra, nuk kemi asnjë kolonë të sistemit të drejtësisë. Nuk kemi sistem drejtësie dhe nuk dihet për sa kohë nuk do ta kemi. Sot reforma? Në drejtësi ka dalë nga të gjitha shinat dhe treni ka ngecur në zhavorr. Zoti komisioner, pa e rikthyer trenin në shinat e Kushtetutës, siç u vendos me konsensus, do të vazhdoni të habiteni", e mbylli Bylykbashi.

Komisioneri i Zgjerimit në Tiranë: Opozita të votojë magistratët

Hahn: Buxhet e njerëz të kualifikuar për negociatat, s'ka kushte shtesë

Rama: Së shpejti, platformë bashkëpunimi me opozitën



Darina Tanushi

Qeveria shqiptare nisi dje në prani të komisionerit për Zgjerimin, Johannes Hahn fazën përgatitore të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian. Kryeministri Edi Rama dhe komisioneri evropian për Zgjerimin, Johannes Hahn u takuan me anëtarët e qeverisë dhe drejtuesit të administratës publike për këtë proces. Pas falënderimeve të rastit për komisionerin, kryeministri Rama u shpreh në fjalën e tij se, "vendimi i Këshillit Evropian i qershorit shënon një moment shumë të rëndësishëm, që konsolidon përfundimisht perspektivën evropiane të Shqipërisë dhe përcakton paktheshmërinë e rrugës së anëtarësimit në Bashkimin Evropian, duke i hapur rrugë shtratit për të filluar negociatat mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian vitin e ardhshëm". "Jemi shumë të vetëdijshëm, se përderisa arritëm të marrim një rekomandim pozitiv pa kushte, si rezultat i punës së bërë, asgjë nuk na pengon që edhe punën e madhe që kemi përpara në këta 12 muaj ta bëjmë me cilësi të lartë dhe ta bëjmë pa asnjë të sharë, kur i themi ne në shqip", theksoi kryeministri. Kreu i delegacionit shtetëror për ndërveprimin me të ngushtë dhe në vijim për procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian do të jetë ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, bëri me dije Rama. Ai theksoi se, "prej këtyre momentit dhe deri në pranverën e ardhshme, ne do t'i marrim të gjitha masat e nevojshme administrative dhe financiare që misioni ynë në Bruksel të zgjerohet dhe të përfshijë edhe përfaqësuesit e institucioneve të tjera të linjës, në respekt të kuadrit ligjor ekzistues". Kryeministri foli edhe për reformën në drejtësi, pavarësisht se nuk ka asnjëherë asgjë perfekte dhe të përpërmirësueshme. Pastrimi i sistemit të drejtësisë është një proces i paktheshëm dhe përjashtimi nga pallati i drejtësisë, një pas, një, i shumë figurave që deri dje mbanin peng drejtësinë dhe ishin superpushteti i këtyre vendit, është një provë domethënëse e vullnetit".



Kryeministri Edi Rama dhe komisioneri evropian për Zgjerimin, Johannes Hahn, gjatë takimit të djeshëm

Meta pret Hahn: Gjithëpërfshirja dhe besueshmëria, element kyç për reformat

Presidenti i Republikës, Ilir Meta priti dje në një takim Komisionerin Evropian për Politikën e Përgjithshme dhe Negociatat e Zgjerimit, z. Johannes Hahn. Në vijim të vendimit të Këshillit Evropian të qershorit, Presidenti Meta çmoi angazhimin e menjëhershëm të Komisionerit Hahn për nxitjen e hapave të mëtejshëm drejt çeljes së negociatave të anëtarësimit vitin e ardhshëm. Sipas njoftimit për shtyp të Presidencës, Meta vlerësoi mundësinë bashkëpunimit dhe të një leximi të përbashkët të përmbushjes së sfidave madhore për të garantuar çeljen e negociatave. "Gjithëpërfshirja dhe besueshmëria janë element kyç për ecurinë e suksesshme të reformave", nënvizoi Presidenti i Republikës. Presidenti Meta e cilësoi tejte të rëndësishëm përgjendrimin e agjendës evropiane të tri muajve të fundit tek Ballkani Perëndimor, një mbështetje e qartë e perspektivës evropiane të rajonit.

Ruçi: KE të mundësojë kalimin e fazës post-monitorim për Shqipërinë

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi u takua dje me Frank Schwabe, kryetar i Grupit Social-Demokrat të AP të KE-së dhe zëdhënës i Bundestagut për të drejtat e njeriut. Kryetari i Kuvendit shpreh mirënjohjen e Kuvendit të Shqipërisë për Bundestagun, qeverinë gjermane, Kancelaren Merkel dhe veçanërisht për Partinë Social-Demokrate Gjermane për mbështetjen e fuqishme që i kanë dhënë Shqipërisë në këtë proces. Kryetari i Kuvendit i sugjeroi Z. Schwabe, në cilësinë si kryetar i Grupit Social-Demokrat të Asamblesë Parlamentare, si edhe të rolit të tij në komitetet e Këshillit të Europës, të vlerësonte marrjen në konsideratë të kërkesës për pranimin e Kosovës në Asambledë Parlamentare të Këshillit të Europës me të drejtën për të pasur një përfaqësim dhe për të folur. Z. Schwabe nënvizoi se këtë çështje do ta diskutojë me presidentin e ri të AP të Këshillit të Europës. Ruçi i sugjeroi Z. Schwabe, në cilësinë e tij si anëtar i Komitetit të Monitorimit, se ka ardhur koha për të negociuar mbi mundësinë e kalimit në fazën e dialogut post-monitorim për Shqipërinë. Z. Schwabe nënvizoi se Këshilli i Europës e ndjek me vëmendje përpërmirimin e Shqipërisë dhe në këtë kontekst do të vlerësojë edhe statusin e monitorimit. Z. Frank Schwabe vlerësoi progresin e Shqipërisë drejt standardeve evropiane dhe vendimin e Këshillit Evropian për përcaktimin e rrugës drejt hapjes së negociatave të pranimit me Shqipërinë në qershor 2019. Grupi social-demokrat në AP të Këshillit të Europës - nënvizoi ai - do të nxisë e mbështetë hapjen e negociatave me Shqipërinë. Por është shumë e rëndësishme që Shqipëria të vazhdojë progresin në dy drejtime të rëndësishme: reformën zgjedhore dhe luftën kundër korrupsionit. Deputeti gjerman u prit edhe nga kreu i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla.

DEKLARATA
"Rekomandimet janë shumë të qarta. Nuk kanë vend për ekuivok apo për keqkuptime, që ne i krijojmë edhe aty ku s'ka, por në këtë rast, procesi është i shoqëruar edhe nga Komisioni, edhe nga të tjerë aktorë dhe është një mundësi e mirë që në tryezën e reformës zgjedhore, bashkërisht me opozitën, në të japim një rezultat në një kohë të shpejtë", tha dje Rama.

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR PROCESIN E "SCREENING"

Procesi i negociatave për anëtarësim të vazhdojë dhe të ngrihet mbi procesin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit.

- Kreu i delegacionit shtetëror për dialogun politik me Komisionin dhe vendet anëtare të Bashkimit Evropian do të jetë ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Dimitri Bushati.
- Për koordinimin teknik të procesit të "screening" dhe punës përgatitore për hapjen e negociatave, qeveria shqiptare cakton zv.ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme, Genti Cakaj.
- Njësi ekzistuese e koordinimit të procesit të integritetit evropian në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme do të forcohet për t'u shndërruar në Sekretariatit e ardhshëm, i cili do të sigurojë në kohë dhe cilësi ndërveprimin institucional dhe monitorimin e procesit.
- Fuqizimi i strukturave koordinuese dhe përgjegjëse në Ministrinë e Linjës dhe veçanërisht në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Brendshme, të cilat mbajnë dhe barren më të madhe të procesit të "screening" për kapitujt 23-24. Kapitujt këta, të cilët përkohë edhe me fushat prioritare të reformave të brendshme në drejtësi të forcimit të shtetit të së drejtës.

KOMISIONERI
Nga ana e tij, komisioneri Johannes Hahn tha se, "ky është hapi i parë i procesit të

negociatave që shtrihet përpara nesh". "Së bashku po hyjmë në një fazë të re, e cila do të jetë një kërkues për të dyja palët. Në muajt në vijim, duke nisur mundësisht që për shtatorit, do të zhvillohen takime në Bruksel, kapitull pas kapitulli, duke pasur një fokus të fortë tek kapitulli 23 dhe 24. Shërbimet e mia po hartojnë një kalendar, të cilin do ta ndajmë me ju shumë shpejt, me qëllim që administrata juaj të bëjë të gjithë përgatitjet e nevojshme. Do të jetë thelbësore në periudhën që vjen që të caktohen burime të mjaftueshme në personel e buxhetore nga ana juaj, që të përballeni në mënyrë me efektive me këtë proces kaq teknik e të detajuar. Në fakt, po shoh ministrin e Financave, megjithatë nuk është vetëm ai, por në çdo ministri të linjës do t'ju duhet një personel i mjaftueshëm, me përvojë, i cili do të negociojë me ne, sepse nuk është dështim që mund t'ia lini vetëm Ministrisë së Jashtme, apo Kryeministrit. Është e nevojshme që të kihet njerëz me njohuri në të gjitha ministratë tuaja, sepse do të negocioni jo vetëm me ne. Ne do të jemi në tryezë gjithmonë, kur do të negocioni me drejtorin e specializuar të Komisionit, ndaj është e rëndësishme që nga të dyja palët të kemi njerëz me përvojë, në mënyrë që të kryejmë këtë procedurë kaq të rëndësishme", sugjeroi Hahn. "Të gjitha reformat që kanë nisur duhet të vijojnë dhe natyrisht që shtetet anëtare do ta shohin me kujdes këtë gjë", theksoi Hahn. "Vetë duhet të vijojë së bashku me strukturimin e pritsëhmërisë institucionale të gjyqësorit, si dhe krijimin e institucioneve të reja

që parashikohen nga reforma kushtetuese e 2016-ës. Në fakt, më lini të theksoj se falë suksesit të procesit të vetëngut deri më tani, është e rëndësishme që vendimet për përfundimin e kësaj reforme duhet të shihen me kujdes, sidomos Parlamenti duhet të amendojë ligjin për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve, në mënyrë që Shkolla e Magistraturës të rritë numrin e studentëve të rekrutuar e trajnuar që prej fillimit të këtij viti. Është shumë e rëndësishme që edhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor të emërohen. Është përgjegjësi e përbashkët e qeverisë dhe e opozitës që të zbatojë shpejt reformën në drejtësi dhe në një farë mënyre do të ishte e çuditshme, do të thosha, që si rezultat i një procesi të suksesshëm vetëngut, ju të haseni me një situatë ku të mos kenit gjyqtarë kompetentë. Kjo do të ishte vërtetë një dizastër, si rezultat i këtij procesi mjaft të suksesshëm. Kështu që do dua t'u bëja thirrje të gjitha palëve politike, sepse ju duhet një shumicë e cilësuar në parlament për të vendosur lidhur me këtë", deklaroi më tej Hahn. Ai shprehur habi që edhe për këtë duhet shumicë e cilësuar votash në Kuvend. Kërkesë tjetër e Hhan ishte edhe vijimi i luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, por edhe reforma zgjedhore dhe trajtimi i rekomandimeve të ODHIR-it përpara zgjedhjeve të ardhshme, që në fakt përputhen shumë me këtë hapësirë, pra të qershorit. "Në fakt, agjenda është shumë e qartë, nuk ka të reja apo surpriza për ju në këtë drejtim. Do të doja t'ju thosha që komisioni do të vijojë të shoqërojë përpjekjet tuaja. Megjithatë, topi është qartësisht tashmë në fushën tuaj. Ju duhet të bëni përpjekje të vazhdueshme për të qenë në kontakt me shtetet anëtare dhe për të vërtetuar progresin për çështjet e ndryshme të ndeshme", tha Hahn. Edhe kryeministri Rama tha se, "dialogu i vazhdueshëm me opozitën duhet të kërkohet duke forcurur në të njëjtën kohë edhe përfshirjen e shoqërisë civile". "Shumë shpejt do të paraqesim një platformë propozimesh për bashkëpunim me opozitën. Do të kërkojmë angazhimin e opozitës, pa kërkuar dhe pa pretenduar për asnjë çast që opozita të lërë menjënjë betejën e saj politike, ashtu siç ajo e mendon në të drejtën e saj, por duke pretenduar që në këtë proces, Shqipëria të jetë e para dhe pastaj interesat e partive dhe dinamikat e betejës politike të vijojnë me pas", tha Rama.

KODI RRUGOR DEBATI

"Merr patentën po pagoi dyfishin e gjobës", PD kundër ndryshimeve në Kodin Rrugor për pushuesit

"Siguria", PD: Qeveria ka 5 vjet që vjedh. PS: Skandalozë

Noka: Babëzia erdhi në pushtet bashkë me 'Zogun' e Tiranës

Valentina Madani

Partia Demokratike nuk mori pjesë dhe në votimin e Kodit Rrugor, edhe pse në parim ishte dakord me propozimin që shtetasit e huaj dhe emigrantët të mund të shpëtojnë pezullimin e patentës duke paguar dyfishin e gjobës. Në Komisionin e Sigurisë ndryshimet kaluan vetëm me votat e mazhorancës, ndërkohe që nisma do të mbesë në sipërari kur opozita të japë konsensus, pasi duhen 84 vota. Teksa Ministria e Brendshme ka propozuar 10-fishimin e gjobave për shoferët, të cilët do të kapen duke përdorur telefonin celular në makinë, deputeti socialist Pjerin Ndreu ka propozuar një nen të veçantë sipas të cilit, shtetaseve të huaj që udhëtojnë në vendin tonë mos t'u pezullohet leja e drejtimit në rast shkeljeje, me kushtin e pagimit të dyfishit të vlerës maksimale të gjobës. Ky projektligj u diskutua në Komisionin e Sigurisë Kombëtare, ku deputeti i PD, Ervin Salianji, në emër të opozitës u shpreh kundër rritjes së kësaj gjobe. "Ju nuk jeni autoritet fetar dhe as mësues kujdestarë. Boll u tallët me 'show', jepini zgjidhje torturës së qytetarëve me radhë nëpër komisione patentash, me pagesat në Kinostudio dhe me bllokim makinash në cepin tjetër, me gjoba të larta dhe me korrupsion të nivelit të lartë. Sillni ligje vetëm për ashpërsimin e masave represive për qytetarët, për kundrvajtje dhe keni zbutur ligjet për drogën, për krimet, për korrupsionin. Duhet riparë Kodi Rrugor për të pasur lehtësira për qytetarët dhe jo si mundësi për të zhvatur para qeveria. Çdo ashpërsim i masave represive rrit potencialin për korrupsion. Përveç

turpit tjetër që ligji funksionon vetëm për të varfrit ose qytetarët dhe jo për pushtetarët dhe të fortët", theksoi z.Salianji. Ndryshimi i Kodit Rrugor kërkon 84 vota, të

cilat mazhoranca nuk i ka. **DEBATET** Debatit në Komisionin parlamentar të Sigurisë u përqendrua më tej tek situata e rritjes së kriminalitetit

në vend. Deputeti i PD-së, Flamur Noka, akuzoi institucionin e vetingut se po përdor standard të dyfishtë për shkarkimin e gjyqtarëve, ndërsa këtë situatë e lidhi politikisht. Noka deklaroi se një gjyqtar u shkarkua pse nipi i tij ishte arrestuar me një sasi të pakonsiderueshme kanabisi, ndërsa tha se ministri i Brendshëm ka vëllain trafikant dhe vijon detyrën. "Gjyqtar Dizdari shkarkohet sepse ka një kushëri që paska probleme, gjyqtari Tom Ndreca shkarkohet sepse kunati i tij genka kapur me 0.4 gr hashash dhe qeveria juaj e quan anëtar të krimtë të organizuar. Ndërsa vëllai i ministrit të Brendshëm, i dënuar për trafik droge nuk genka anëtar i trafikut të drogës", theksoi deputeti i PD-së.



Komisioni parlamentar i Sigurisë Kombëtare

DEBATI TE "SIGURIA" NGA "HIENAT", TE "ZOGU" I TIRANËS

FLAMUR NOKA: Kemi raportin e antidrogës italiane. Shqipëria u bë aerodrom i avionëve të drogës. Të gjithë i panë. Adriatiku u kthye në autostradë të drogës. Ky kryeministër mashtrues, që quhet narkoedrima. Raporti thotë që sekuestroreshin 41 tonë në ditë. E mbani mend para disa kohësh siç thoshte që nuk ka drogë në Shqipëri, një ditë të bukur tha që e fituam betejën me drogën. Tha që 99.8 për qind e drogës në Shqipëri është zhdukur, droga gjithandaj. Gjyqtar Dizdari shkarkohet sepse ka një kushëri që paska probleme, gjyqtari Tom Ndreca shkarkohet sepse kunati i tij genka kap me 0.4 gr hashash dhe qeveria juaj e quan anëtar të krimtë të organizuar. Ndërsa vëllai i ministrit të Brendshëm, i dënuar për trafik droge nuk genka anëtar i trafikut të drogës.

PJERIN NDEU: Është emergjente, sepse jemi përballur me situata skandalozë.

ERVIN SALIANJI: Po të shkosh për të dalë në komisione duhet të shkosh që në 5 të mëngjesit dhe nuk i japin zgjidhje çdo ditë. Prandaj ky propozim për një nen të posaçëm nuk zgjidhet në këtë situatë.

FLAMUR NOKA: Është shndërruar në një noter të qeverisë. Tashmë është e qartë që edhe në ligjet që kalojmë, ky parlament ka humbur sensin. Ka rezultuar që është noter i

babëzisë së kryeministrit. 'Zogu' i Tiranës është. Është e paprecedentë që qeveria pasi ka vjedhur për 5 vjet rresht, t'i turrat si hiena pronës publike. Sepse duhet të vidhet historia e këtij vendi që nga dita kur mister babëzia erdhi në pushtet bashkë me 'Zogun' e Tiranës.

XHEMAL QEFALIA: Indrit Fortuzi është 'Zogu' i Tiranës.

ERMONELA FELAJ: Procedura është e gjatë dhe burokratike dhe menduam që kjo alternativë do të ishte e duhura. Duam mendimin e opozitës.

ERVIN SALIANJI: Ju nuk jeni autoritet fetar dhe as mësues kujdestar. Boll u tallët me 'show', jepini zgjidhje torturës së qytetarëve me radhë nëpër komisione patentash, me pagesat në Kinostudio dhe me bllokim makinash në cepin tjetër, me gjoba të larta dhe me korrupsion të nivelit të lartë. Sillni ligje vetëm për ashpërsimin e masave represive për qytetarët për kundrvajtje dhe keni zbutur ligjet për drogën, për krimet, për korrupsionin. Duhet riparë Kodi Rrugor për të pasur lehtësira për qytetarët dhe jo si mundësi për të zhvatur para qeveria. Çdo ashpërsim i masave represive rrit potencialin për korrupsion. Përveç turpit tjetër që ligji funksionon vetëm për të varfrit ose qytetarët dhe jo për pushtetarët dhe të fortët.



ERVIN SALIANJI

"Ju nuk jeni autoritet fetar dhe as mësues kujdestarë. Boll u tallët me 'show', jepini zgjidhje torturës së qytetarëve me radhë nëpër komisione patentash, me pagesat në Kinostudio dhe me bllokim makinash në cepin tjetër, me gjoba të larta dhe me korrupsion të nivelit të lartë", deklaroi deputeti i PD-së.



PD, Duma: Të ngrihet një Task Forcë që monitoron masat antikorrupsion e antitrafik

Deputetja demokrate, Grida Duma propozon ngritjen e një Task Force që të monitorojë ecurinë e masave antikorrupsion dhe antitrafik. Në pamundësi të zhvillimit të mbledhjes së Komisionit të Integritetit, Duma e postoi propozimin e saj në "Facebook": "Propozoj që nën mbikëqyrjen e Këshillit Kombëtar të Integritetit të ngrihet një Task Forcë e posaçme, që monitoron ecurinë e masave antikorrupsion dhe antitrafik. Duke qenë se e ardhmja europiane e Shqipërisë tashmë është në stacionin e fundit të Ballkanit për çështjet më të rënda të korrupsionit dhe drogës që janë cituar si detyra duhet të nisë kontrolli politik me qasje të integritetit". Sipas Dumës, Task Forca duhet të jetë politike, e përbërë nga mazhoranca dhe opozita. "Edhe në artikulat aktualë të gazetave të huaja për drogën dhe aferën e prishjes së Teatrit Kombëtar, del qartë që as ndëshkimi i moshapjes se negociatave nuk ka dhënë asnjë efekt, madje është marrë si avantazh që në mungesë të kontrollit të vijohet më rëndë me korrupsion dhe drogë. Për mua, kjo Task Forcë duhet të jetë politike me mazhorancën dhe opozitën madje".

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Permbartimore "E.G Bailiff Service" me permbartues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rrova, Pallat 64, Hyrja E, Ap 1, Tirane, ngritjen e me date 10.08.2018 ora 8^h -16^h ne ambjentet e saj, do te zhvillohet: Ankandit I I per shiten e pasurise te paluajtshme Tualli me sipërfaqe 24,405.50 m² e ndodhur në rugin "Ali Shefqet", Tiranë me Nr.pasurie.9/609, Volumi.20, Faqe.6, në pronësi të Shoqërisë B&U- CONSTRUCTION sh.p.k me vlerë fillestare ne ankand 341,676.72 (Treqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e dy) EURO .

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 381. email enuar.merko@gmail.com

SHPALLJE ANKANDI

Datë 24.07.2018, Ora 16:00:00

Shoqëria Përmbartimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506425, Cel. 067 201 9460/ 069 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.

Shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Enkeleja Novaku dhe dorëzuesit Adriatik Novak:

"Tualli" me sipërfaqe 100 m² dhe "Ndërtesa" me 3 kate me sipërfaqe 90 m² secili, 2 kate të miratuara me Vendim për Leje Ndërtimi Nr. 22 datë 29.04.1996 të Këshillit Bashkiak Pogradec, nr. i pasurisë 4/106, zona kadastrale 8581, vol. 13, faqe 69, adresë: Lagja Nr. 1, Pogradec.

Çmimi fillestar i ankandit të parë është në shumën 10.400.000 (dhjetë milionë e katërqind mijë) lekë.

Ankandit do të zhvillohet në ambjentet e Shoqërisë Përmbartimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë

Permbartuesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr per shetje ne ankand pasurine :

"Toke Are me sip 865 m², me Nr pasurie 131/86 Zona kadastrale nr 1896, Volumi 9, faqe 44 , me vendndodhje Grude e re Shkoder .

2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërpërkshuar , është në vleren 302,400 (Treqind e dy mijë e katërqind) Lekë .

Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) ne date 27.07.2018 ora 16.16 ne Zyren e permbartuesit gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko , Perballë Gjykatës se rethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet te derchin perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051,



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, gjatë një seance parlamentare

Valentina Madani

Komisioni i Medias dhe Edukimit u përfshi edhe në debate të ashpra mes ministres së Arsimit, Lindita Nikolla dhe kryetares së Komisionit të Medias, demokrates Albana Vokshi. Shkak u bë shpërndarja e dëftesave në sistemin parauniversitar: Vokshi i tha Nikollës se dëftesat nuk janë shpërndarë, ndërsa kjo e fundit iu përgjigj se Ministria e Arsimit ka pajisur me diploma të gjithë maturantët që kanë pasur kërkesë për të vazhduar studimet jashtë vendit. Gjatë diskutimeve në Komisionin e Medias, ministria e Arsimit, por nga Ministria e Brendshme. "Keni mashtruar publikisht në lidhje me lëshimin e dëftesave për të gjithë fëmijët që ndjekin arsimin parauniversitar. Keni gënjyer për dëftesat, ja ku e keni dëftesën që është e gabuar dhe e keni mohuar këtë fakt. E keni çuar në shkollë, keni detyruar mësuesit të lënë pushimet dhe të vinë në shkollë dhe më pas i keni urdhëruar të kthehen

Ministrja: Tenderin për dëftesat s'e bën ministria, u vonuan për një gabim

Debati për dëftesat, Vokshi: Mashtruat! Nikolla: Do ju padis

Boçi: Hajde dhe shkojmë bashkë në prokurori



Komisioni i Medias dhe Edukimit

mbarsht 35 mijë dëftesa liri, për të cilat dikush duhet të mbajë përgjegjësi. Keni mashtruar kur keni thënë se dëftesat janë shpërndarë, kemi mesazhe ku mësuesit thonë se do ndahen në shta-

tor. Duhet t'u kërkonti ndjesë të 420 mijë fëmijëve që nuk marrin dot dëftesat. Do ishte në dinjitetin tuaj që minimalisht një ndjesë publike dhe pa kërcënuar deputetët e opozitës, se jeni ju që keni

shpërdoruar detyrën", deklaroi zj.Vokshi. Por, ministria e Arsimit paralajmëroi apelin në prokurori për shpifje. "Po gënjeni, çështjen do ta apeloj në prokurori. Shpif, shpifse diçka mbetet, s'mund

PËRPLASJA
Deputetja Vokshi i tha ministres Nikolla se dëftesat nuk janë shpërndarë, ndërsa kjo e fundit iu përgjigj se Ministria e Arsimit ka pajisur me diploma të gjithë maturantët që kanë pasur kërkesë për të vazhduar studimet jashtë vendit.

të vazhdojë kështu. Ne punojmë me mish e me shpirt, kërkojmë një sjellje tjetër. Ju jam përgjigjur në kohë të gjithë maturantëve që u duhej diploma për të ikur jashtë shtetit. Komunikoj falë Zotit me prindërit. Ju sapo gënjyet. Të lutem zonjë, kërkoje përgjigjen time, do më lesh të përgjigjem", deklaroi Nikolla. Por Vokshi replikoi sërisht: "Ja ku janë SMS-të që u janë dërguar prindërve. Ja ku thuhet që dëftesat do ndahen në shtator se nuk kanë ardhur. Ne jemi këtu për të sjellë zërin e 420 mijë fëmijëve. S'po flasim vetëm për maturantët. Kam pyetur një mikeshën time, ja ku thuhet se s'ka dëftesa. S'vini dot këtu e të kërcënoni opozitën, pasi bëni pazaret tuaja. Përgjegjësia për tenderin bie mbi ju. Se mbulon dot zullumin tim". Ministria Nikolla duke hedhur poshtë pretendimin tha se i është drejtuar prokurorisë për akuzat e opozitës, që nga deputetët e opozitës u interpertua edhe si presion dhe kërcënim. "Mungesa e etikës është ajo që ju karakterizon, ndaj do ju përgjigjesha me Linditën etike. Do t'i shkoj deri në fund në organet e drejtësisë të gjitha akuzave që janë bërë publike në adresë të personit tim", theksoi Nikolla. Për këtë, deputeti tjetër i PD-së, Luçiano Boçi i tha zj.Nikolla: "Ju jeni përgjigjur dhe në formë kërcënuese në lidhje me çështjen e prokurorisë. Në fakt, e mirëpres ftesën tënde të shkojmë bashkë, se kush është denoncuesi, do e gjejmë atje, në prokurori". Në komision u diskutuan disa ndryshime të ligjit parauniversitar që përfshijnë ngritjen e shkollës së drejtorëve dhe pushtimit e mësuesve, që opozita i konsideroi si të tjera përpjekje për të politizuar procesin arsimor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I KOMISIONERIT PUBLIK

NJOFTIM

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, "Për miratimin e strukturës organizative, organikut dhe klasifikimit të pagave të personelit të Institucionit Komisionerëve Publikë", rishpall vendet vakante për pozicionet:

Përkthyes (paga II-b)

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:
- Të zotërojë diplomë të nivelit Master shkencor në gjuhë të huaja, dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimumi 5 vjet eksperiencë në përkthim shqip-anglisht-shqip.
 - Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët.
 - Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

Preferohen kandidaturat e licencuara përkthyes zyrtar nga Ministria e Drejtësisë.

Specialist Protokoll/Arkiv (IV-b)

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:
- Të zotërojë diplomë të nivelit Master shkencor.
 - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie, sipas Vendimit të Këshillit Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës dorazi nga aplikanti nga data 23 deri 27 korrik 2018, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 4, Tiranë, nga e hëna në të premtë, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 4, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 27.7.2018 dhe të vërtetohet me fletëmandatin e lëshuar nga zyra postare.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përfaqëton vendin vakant, për të cilin është i interesuar. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon të mbyllura në zarf: 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrimin profesional përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, pasaportë, kartë identiteti).
- Dokumentet (diplomë, librezë pune, vërtetime, dëshmi, vetëdeklarim, certifikata, trajnime etj.) fotokopje ose të noterizuara. Diplomat që janë marrë jashtë vendit duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Dokument që vërteton se në angrikim të tij nuk është regjistruar një procedim penal (vërtetim nga Gjykata, vërtetim nga Prokuroria, dëshmi e gjendjes gjyqësore).
- Vërtetim nga institucioni ku punon që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Një rekomandim nga punëdhënësi.
- Raport që vërteton se është në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme.

Kandidatët që plotësojnë kriteret formale dhe kanë deponuar dokumente të fotokopjuara, përpara intervistës i parashtrojnë Komitetit ad-hoc dokumentet e njësura ose ato origjinale.



"Raporti i BSH provon pastrimin e parave"

Tabaku: Vetëm në qershor u mbyllën 1 mijë e 300 biznese

Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku gjatë fjalës së saj në Komisionin e Ekonomisë deklaroi se bizneset e ndershme e kanë të pamundur të operojnë në ekonomi. Duke u ndalur tek shifrat, ajo tha se vetëm gjatë qershorit 2018 u mbyllën 1 mijë e 300 biznese. Kjo shifër - siç tha ajo - është 92% më shumë se sa qershorin i 2017-ës. Tabaku i kërkoi parlamentit dhe guvernatorit të bankës t'u vënë në dispozicion deputetëve të opozitës raportin e publikuar për paratë e pista. "Raporti që ka bërë departamenti i mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë provon katërcipërisht atë që opozita ka theksuar gjatë një viti, pastrimin e parave", - u shpreh Jorida Tabaku në Komisionin e Ekonomisë, duke vënë në dukje se afëra korruptive e teatrit është shembulli konkret i pastrimit të parave. "Fakti që asnjë zyrtar nuk është në gjendje të përgjigjet na bën të dyshojmë se kjo kontratë nuk është prodhuar në zyrat e shtetit. Afera e teatrit është shembulli më i fortë, dëshmon se paratë e krimi dhe të drogës janë duke depërtuar në ekonomi", - tha Tabaku. Nën kryetaria e Komisionit të Ekonomisë theksoi se është sektori i ndërtimit, fusha ku po pastron paratë. Tabaku citoi raportin aktua konfidencial të Bankës së Shqipërisë: "Në disa raste nuk disponohen dokumente që provojnë burimin e fondeve, të cilat kryesisht mbeten në nivel deklarata për transaksione të kryera nga klientët me para fizike cash, në llogari individuale tregtare". "Bizneset e ndershme sot janë duke mbyllur dyert e tyre. Informacioni që kemi marrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit thotë që: "Vetëm në qershor 2018 kanë kaluar pasiv, 1 mijë e 300 biznese. 92% më shumë se sa qershorin i 2017-ës", deklaroi Tabaku.

Do të përzgjidhen 150 kandidatë. Nuk pranohen personat e larguar nga shërbimi civil

TIRANË

Për të gjithë të intere-suarit që duan të ndjekin studimet në Akademinë e Sigurisë, Kolegjin e Lartë Profesional dhe Kolegjin e Policisë për "Patrullë të Përgjithshme", Policia e Shtetit ka bërë publike kriteret të cilat duhet të plotësojnë. Në njoftimin për mediat, policia bën me dije se aplikimet do të nisin më 20 korrik, proces ky që do të përmbyllet më 20 shtator. Mësohet se në përfundim të të gjithë procesit të konkurrimit do të përzgjidhen 150 kandidatë fitues, të cilët do të vazhdojnë Shkollën Bazë të Policisë, nga të cilët 19 % për gjininë më pak të përfaqësuar dhe 1.9% për minoritetet.

NJOFTIMI I POLICISË SË SHTETIT

Shpallen aplikimet për të ndjekur studimet në Akademinë e Sigurisë, Kolegjin Profesional i Lartë, Kolegjin e Policisë për "Patrullë të Përgjithshme". Me qëllim kryerjen e një procesi përzgjedhës të drejtë, të paanshëm dhe transparent, sipas parimit të shanseve të barabarta, meritës dhe mosdiskriminimit, Policia e Shtetit bën me dije për të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të konkurrojnë në Akademinë e Sigurisë për "Patrullë të Përgjithshme", se në 20 korrik 2018 hapet procesi i aplikimeve për të gjithë kandidatët e interesuar të ndjekin studimet në Shkollën Bazë të Policisë për "Patrullë të Përgjithshme".

APLIKIMI

Aplikimi do të bëhet pranë Drejtorive Vendore të Policisë, ku aplikanti ka vendbanimin e përhershëm. Procesi i aplikimit është i hapur deri në 20 shtator 2018 dhe formularët e aplikimit mund të tërhiqen pranë çdo Drejtorie Vendore të Policisë.

Në përfundim të të gjithë procesit të konkurrimit do të përzgjidhen 150 kandidatë fitues, të cilët do të vazhdojnë Shkollën Bazë të Policisë, nga të cilët 19 % për gjininë më pak të përfaqësuar dhe 1.9% për minoritetet.

Hapen aplikimet për Akademinë e Sigurisë, Policia: Ja kriteret që duhet të plotësoni

Afati, konkurrimi nga 20 korriku deri më 20 shtator

Kur nuk plotësohet kuota e përcaktuar për gjininë më pak të përfaqësuar dhe minoritetet do të merren në mend zbritës aplikantët, të cilët përfaqësojnë po këto kategori, por që duhet të kenë arritur minimumin e pikëve për t'u shpallur fitues.

KRITERET E PERZGJEDHJES

Kriteret që duhet të përmbushë aplikanti për të ndjekur studimet në Akademinë e Sigurisë Kolegjin i Lartë Profesional "Kolegji i Policisë" për "Patrullë të Përgjithshme" janë:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të mos jetë i përjashtuar nga Policia e Shtetit, apo të jetë larguar nga shërbimi civil.
- Të ketë tëzotësi të plotë për të vepruar.
- Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën.
- Të ketë mbaruar arsimin e mesëm.

- Të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundravajtje penale me dashje.

- Të jetë i pajisur me vërtetim besueshmërie.

- Të ketë dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit "B".

DUKUMENTACIONET PËR APLIKIM

Aplikantët për punonjës policie duhet të paraqesin dukumentacionin e mëposhtëm:

- Formularin e aplikimit.
- Fotokopje të kartës së



Foto ilustruese

identitetit.

- Dokument zyrtar që vërteton përfundimin e arsimit.

- Fotokopje të dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit "B".
- Certifikatë të gjendjes gjyqësore.
- Vërtetim nga gjykata.
- Vërtetim nga prokuroria.
- Raport mjeko-ligjor.
- Fotokopje të librezës së punës ose vërtetim që ndjek arsimin e lartë (mëse i disponon).
- Dokument të lëshuar nga institucionet shëndetësore, që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Mandatpagesën e tarifës së aplikimit.

struktura vendore i aplikantëve, që nuk plotësojnë kriteret për të vazhduar testimin.

- Dërgimi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore i listës emërore të aplikantëve, që plotësojnë kriteret e përcaktuara.

- Hartimi i listës përfundimtare të aplikantëve, që plotësojnë kriteret dhe caktimi i numrit kodik për çdo aplikant nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

- Pajisja e çdo aplikanti me formularin e pranimit dhe numrin kodik nga strukturat vendore të burimeve njerëzore.
- Publikimi në websit-in e Policisë së Shtetit dhe në media i njoftimit për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të konkurrimit, si dhe listën e kandidatëve që kualifikohen.

- Procesi i apelimit.

- Konkurrimi.

Shqyrtimi i dokumentacionit dhe procesi i ankimit

Afati i shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit është 10 ditë pune nga mbyllja e afatit të aplikimeve.

Aplikanti që nuk plotëson kriteret dhe nuk ka paraqitur dukumentacionin e kërkuar brenda afatit të aplikimit, skuallifikohet duke u njoftuar me shkrim nga struktura e burimeve njerëzore.

Aplikanti ka të drejtën e ankimit tek drejtori i Policisë Vendore brenda 2 ditëve nga data e njoftimit të përgjigjes.

Aplikanti ka të drejtën e ankimit tek drejtori i Policisë Vendore brenda 2 ditëve nga data e njoftimit të përgjigjes.

Drejtori i Policisë Vendore shqyrtun dhe kthen përgjigje brenda 5 ditëve nga data e marrjes së ankesës.

Programi dhe fazat e konkurrimit

Aplikanti që kualifikohet për të vazhduar procesin e pranimit në Akademinë e Sigurisë u nënshtrohet fazave të mëposhtme të konkurrimit:

- Testimi me shkrim.
- Testimi i aftësive fizike.
- Intervista me gojë, ushtrime vlerësuese dhe testimi i aftësive të të shkruarit.
- Testimi psikologjik.
- Kontrolli shëndetësor.
- Marrja e shenjave të gishtave.
- Verifikimi përfundimtar i aplikantit.

Strukturat e Burimeve Njerëzore pranë Drejtorive Vendore të Policisë do t'u japin të gjithë aplikantëve formularin e aplikimit, informacionin e nevojshëm për procedurën, kërkesat dhe çdo lloj testi i verifikimit, si dhe për ushtrimin e të drejtës së apelimit.

Të gjithë aplikantët, për çdo paqartësi që mund të kenë lidhur me këtë proces, mund të drejtohen pranë strukturave të Burimeve Njerëzore në Drejtorinë Vendore të Policisë ose pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

Po ashtu, mund t'i parashtronë pyetjet apo shqetësimet e tyre dhe me e-mail në adresën policiaeshtetit@gmail.com ose në faqen zyrtare në "Facebook", "Policia e Shtetit".

United Nations Development Programme

VACANCY ANNOUNCEMENT

The UNDP office in Albania is looking for a qualified candidate who could fill the following vacancy.

Post Title: OSSH Public Serv Delivery Specialist

Duty station: Tirana

Duration of Assignment: 1 year with possibility of extension

Type of Contract: Service Contract

Educational Background: Master degree in IT/Computer Science, Engineering, Management or any other related field. Preferable PMP, Prince 2 Practitioner or alternative internationally recognized certificate with validity and certification process through testing center. IT Service Management Certificate, ITIL or similar would be an asset.

Work Experience: Minimum 5 years of professional experience IT and information system field. Previous experience in successful completion of IT and information Projects in local government or related field is an advantage. Previous work experience with local governments in the area of service delivery is highly preferred.

Demonstrated understanding of Albania's local governance system. Experience in integrated governance programming / institutional development.

Tentative Starting Date: 13 August 2018

Deadline for Application: 27 July 2018

Job Description: Available at UNDP site: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>

Interested and qualified candidates are requested to submit their application online only (available at <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>). Incomplete applications will not be considered. Only short-listed candidates will be notified.

United Nations Development Programme

VACANCY ANNOUNCEMENT

The UNDP office in Albania is looking for a qualified candidate who could fill the following vacancy.

Job ID: 17471

Post Title: Local Gov Capacity Delivery Specialist

Duty station: Tirana

Duration of Assignment: 1 year with possibility of extension

Type of Contract: Service Contract

Educational Background: Master Degree in Social Sciences, Local Governance, Public Administration, Local Economic Development, Law or any other relevant field ;

Work Experience: Minimum 10 years of professional experience. At least 7 years of professional experience at expert level with a public administration and/or international institutions in supporting institutional building related to organizational reform, change management, local finances, HR development, or similar. Minimum of 5 years senior-level experience in organizational development and provision of technical assistance to government entities. Demonstrated capabilities in institutional capacity development, and experience in working effectively with local governments, civil society organizations and other development partners. Demonstrated understanding of methodologies appropriate to complex change processes and capacity development. Demonstrated technical expertise in providing technical support and/or capacity building to government institutions in leadership and governance, and/or resource administration. Demonstrated ability to assemble, quickly and effectively, and to manage a highly-skilled, interdisciplinary team; to interact with and lead a broad range of governmental and non-governmental actors and institutions across sectors. Proven experience of team management comprising international and local experts; ability to operate within multi-sectoral, and multi-cultural teams.

Tentative Starting Date: 13 August 2018

Deadline for Application: 27 July 2018

Job Description: Available at UNDP site: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>

Interested and qualified candidates are requested to submit their application online only (available at <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>). Incomplete applications will not be considered. Only short-listed candidates will be notified.



Tom Ndreca



Admir Thanza

Shkarkohen dy gjykatësit Admir Thanza dhe Tom Ndreca, Gjykata e Lartë drejt kolapsit

TIRANË - Vetingu ka shkarkuar dy gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, e cila mbetet me 7 anëtarë nga 19 në total. Pas Kushtetueses, edhe Gjykata e Lartë shkon drejt kolapsit. Dy anëtarët e saj, Tom Ndreca dhe Admir Thanza nuk kanë mundur të kalojnë procesin e vetingut.

Ata u shkarkuan nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pasi nuk përbushin kriteret për të vijuar punën në sistemin e drejtësisë. Thanza për shkak të pasurisë dhe fshesjes së një dënimi për vjedhje të kryer në Itali në vitin 1999. Ndërsa, Ndreca për shkak të kontakteve me per-

sonat me precedentë penalë dhe deklarim të rremë të pasurisë. Dy gjyqtarët nuk kanë qenë të pranishëm në sallë, duke u përfaqësuar vetëm nga avokatët. Me ikjen e dy gjykatësve, Gjykata e Lartë mbetet me 7 anëtarë. Në 20 korrik pritet që para KPK të dalë dhe kryetari i Gjykatës

së Lartë, Xhezair Zaganjori, me të cilin do të zhvillohet një seancë dëgjimore. Megjithatë, edhe me 7 anëtarët, për momentin kjo gjykatë mund të funksionojë vetëm me një kolegji. Kjo do të sjellë vonesa në shqyrtimin e dosjeve dhe rezultati, drejtësi e vonuar për qytetarët. Gjykata e Lartë duhet të kishte 19 anëtarë, por për shkak të mosngritjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk mund të bëhet përzgjedhja e kandidaturave.

Policia: Atentatori shtatgjatë, fqinjët e viktimave patën frikë të njoftonin

Senad Nikshiqi
SHKODËR

Vrasja e dyfishtë në Shkodër, autori priti çiftin 1 orë para pallatit

Ish-polici tentoi të ikte, mori 21 plumba

Ekzekutimi i ish-efektivit të policisë, Boran Bërcana dhe bashkëjetueses së tij, Silvana Ndoci ka alarmuar policinë dhe prokurorinë e Shkodrës, të cilat po punojnë intensivisht për zbardhjen e vrasjes së dyfishtë. Ngjarja kjo që ndodhi në orët e para të mëngjesit të së dielës, në lagjen "Naim Gjylbegu të qytetit verior. Dy ditë pas ekzekutimit mafioz, grupi hetimor ka zbardhur detaje tronditëse. Mësohet se skena makabre ndodhi në sy të djalit 2-vjeçar të viktimave, i cili ishte në sediljen e pasme të makinës tip "Benz" me targa me targë AA 006 HA, ndërsa fatmirësisht nuk mbeti i lënduar. Sipas hetuesve të çështjes, ish-polici Bërcana sapo ka parë atentatorin, ka tentuar të largohet, por plot 21 plumba e kanë bërë shoshë trupin e tij. Pas kryerjes së veprimeve hetimore para-prake, policia e Shkodrës ka ndërtuar skemën se si ka ndodhur ngjarja, e cila tronditi jo vetëm banorët e Shkodrës, por të gjithë opinionin publik.

SKEMA E VRASJES
Sipas burimeve policore, ka qenë një person që ka kryer vrasjen e dyfishtë dhe se ai ka pritur mbi 1 orë deri sa ka mbërritur çifti me makinë (në ora 01:13). Mësohet se ish-polici ka ndaluar mjetin tip "Benz" pak metra para hyrjes së pallatit ku banonte me bashkëjetuesen e tij 25-vjeçare, Silvana Ndoci. Sapo ka ndaluar makina e çiftit, autori është afruar me hapa krejt normalë dhe ka filluar të qëllojë me breshëri në drejtim të tyre. Ndërkaq, 30-vjeçari Borana Bërcana i ka dhënë gaz makinës dhe ka tentuar që të largohet. Autori ka ndjekur mjetin dhe në ecje e sipër ka vijuar të qëllojë duke qenë se shpejtësia nuk ishte e madhe. Makina tip "Benz" është përplasur te tuneli i pallatit. Atentatori ka futur dorën brenda xhamit dhe ka qëlluar në drejtim të Boran Bërcanes dhe Silvana Ndoci duke i lënë të vdekur brenda në makinë. Burimet e mësipërme pohuan për "GSH" se ekzekutori ka shkrëpur 27 plumba mbi dy viktimat, ku 21 prej tyre janë gjetur në trupin e ish-policiut, ndërsa 6 i kishte

IDENTIKITI I VRASËSIT
Nga pamjet filmike konstatohet se autori pasi ka kryer vrasjen, ka hipur në mjetin e tij dhe i vetëm është larguar me shpejtësi. Ende është e paqartë nëse ka qenë me apo pa maskë. Disa ekspertë mendojnë se ai ka vepruar i pamaskuar. Ekspertë të tjerë dyshojnë vrasësi ka pasur diçka në fytyrë. Kjo paqartësi vjen për shkak se nga pamjet filmike të kamerave nuk mund të shihet aq mirë. E sigurt është se atentatori ka pasur kapele në kokë dhe është relativisht i gjatë.



Viktimat Boran Bërcana dhe Silvana Ndoci

bashkëjetuesja e tij. Komshinjtë të pyetur nga policia kanë deklaruar se nuk kanë dëgjuar as përplasjen e mjetit dhe as të qarët e djalit të vogël. Efektivët dyshojnë se fqinjët e viktimave kanë pasur frikë të njoftonin. Për mbi 5 orë trupat e pajetë dhe fëmija kanë qenë

druar brenda mjetit që ishte i ndezur, derisa dikush ka njoftuar policinë dhe ambulancën, të cilat mbërritën në vendngjarje në orën 6:40.

ATENTATORI

Pasi është siguruar se i ka vrasur të dy, autori është larguar nga vendi i ngjarjes. Ai ka hipur në mjetin tip "Benz C Class" dhe është larguar deri në fund të "Rrugës së Gjanë", siç njihet në Shkodër. Pas atij kryqëzimi, policia nuk i di më saktësisht lëvizjet e vrasësit për shkak se nuk ka pasur kamera sigurie. Megjithatë, dyshohet se

ai ka shkuar drejt lagjes "Kiras". Nga aty tek pjesa e Zooteknikës që lidh Kirasin me "By Pass"-in e Shkodrës. Pasi ka dalë në "By Pass", autori ka ecur për rreth 1 km dhe më pas është ndalur. Ka lënë brenda armën automatike "MP5" dhe i ka vënë flakën makinës, duke e djegur për të humbur çdo gjurmë. Mjeti sipas burimeve rezultoi i vjedhur në muajin shkurt të këtij viti në Kosovë, ndërsa targa janë vjedhur në Tiranë. Po ashtu, dyshohet se ka edhe disa pjesë të tjera të vjedhura, të cilat janë montuar për ta përdorur më pas në krimin e rëndë. Policia vijon hetimet, por ende nuk ka ndonjë autor të dyshuar. Mendohet se vrasja e Boris Bërcanes dhe Silvana Ndoci është kryer nga vrasës profesionistë. Pistat kryesore të hetimit vijojnë të mbeten vrasje për shkak të ndonjë konflikti të mundshëm ose larje hesapesh.

SHKURT

Arrestohen 3 të rinj me armë dhe drogë
SHKODËR - Policia e Shkodrës dhe FNSH kanë ndërmarrë një operacion, duke arrestuar tre të rinj me armë e drogë. Bëhet fjalë për shtetasit Enduel Bajraktari, 29 vjeç; Mirjan Ndoj, 27 vjeç dhe Marisjen Gjoka, 20 vjeç, të tre banues në Vaun e Dejës. Ata u kapën, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në ambientet e një euro loto në Vaun e Dejës u gjetën dhe u sekuestruan një automatik dhe dy pistoletë tip "TT". Gjithashtu, gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e Enduel Bajraktarit u gjet dhe u sekuestrua 500 gr kanabis. Ndërkaq, vijojnë hetimet për 3 të rinjtë, pasi dyshohen se janë autorë për disa vepra penale të tjera.

Goditen nga rrufeja, 1 e vdekur dhe 2 të plagosur

SHKODËR - Një 53-vjeçare është goditur për vdekje nga rrufeja në fshatin Suka të njësisë administrative të Dajcit në Shkodër, ndërsa dy persona të tjerë janë plagosur. Ngjarja e rëndë ndodhi teksa 3 personat ishin duke transportuar me traktor ushqim për bagëtitë të tyre. Goditja nga rrufeja ishte fatale për 53-vjeçaren Veronika Luka, e cila humbjetën. Ndërsa, mbeti i plagosur bashkëshorti Cin Luka, rreth 50 vjeç dhe bashkëfshatari i tyre, Ndoj Vija 60 vjeç. Të plagosurit u dërguan në spitalin e Shkodrës ku u është dhënë ndihma e parë mjekësore.

I dënuar s'kthehet në qeli, pezullohen lejet

KORÇË - Prej një muaji një i dënuar ka lënë ambientet e burgut të Drenovës, pasi kishte marrë leje, por nuk është kthyer më. Hëni Myrtishi vuante dënimin në burg për trafik të lëndëve narkotike. Pasi ka marrë leje nga IEVP e Korçës, Myrtishi ka shkuar në shtëpinë e tij, por nuk është rikthyer në burg pas përfundimit të afatit. Ky rast ka penalizuar të dënuarët e tjerë, që vuajnë dënimin në këtë burg, pasi është vendosur pezullimi i lejeve.

Postimi i Antonetës: Nëse ka Zot, të hakmerret ai

Përlot motra e 25-vjeçares së vrasë, Silvana Ndoci: Ma le nipin vetëm, Borisin ju kërkon 'o ma, o ba'...



Antoneta Ndoci, motra e 25-vjeçares së vrare

POSTIMI I PLOTË

A moj motër qa na thave shpirtin mu, mamit, vëllait motrës, s'muna me fjet pa të

than natën ty e Boranit, a moj motër më le nipin vetëm moj, motër Po ti o Boran pse ja dhat besën njani-tjetrit

me ik në këtë mënyrë e me lan Borisin vetëm që ju kërkon o mami o babi. Kuku për mu o Zot, o Zot nëse ka zot ta lëj ty në dor për hakmarrjen e të dyve o dritac e syve të mi se tash shof veç veribm në syt e mi më keni lan një se na freskon shpirtin e na kujton juve kuku për ne push-offi në paqe engjullit e mi fini të qet se do kujdesena ne për Borisin deri në frymën e fundit do ju premtos se s'do mungoj as gjë për veç dashnija juaj moj motër e Boran. O Zot, jepi bekimin tënd të pushoj në paqe këta dy lule të bukura".

Klosi: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vendosur pranimin e 'masës së sigurisë' për 2 aktpadi

Klosi "sulmon" gjykatën: Vendime me hije të forta korruptive për guroret

Ministri: I siguroj qytetarët se angazhimi ynë për zbatimin e ligjit do të jetë maksimal

Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi denoncoi dje vendimet e marra nga Gjykata Administrative Vlorë për lejimin e punës së 2 subjekteve nga 9 të tilla, të cilëve ministria iu ka revokuar lejet për guroret në Malin e Tomorit. "9 leje mjedisore për shkak të shkeljeve të rënda, u revokuan, duke i hequr të drejtën e vijimit të mëtejshëm të aktivitetit dhe 10 të tilla u pezulluan. Në kundërshtim me çdo ligj dhe rregull në fuqi këto biznese, kishin nxjerrë përfitimet financiare në kurriz të malit, qytetarëve që flinin e zgjoheshin me tymin e bardhë të gurëve dhe turizmit të siveve historike dhe kulturore të zonës. Pezullimi dhe revokimi i lejeve mjedisore për këtë aktivitet që kishte shkaktuar as më shumë e as më pak, por një katastrofë të vërtetë natyrore, u morr në zbatim të plotë të ligjit. Mes shumë të tjerash, dy shkeljet më të rënda të konstatuara ishin: ndryshimi i koordinatave të gërmimit nga leja në terren dhe e dyta: mungesa e zbatimit të detyrimit ligjor për rehabilitimin e zonës së gërmuar", deklaroi Ministri i Turizmit dhe Mjedisit Blendi Klosi. Sipas tij, vendimi i Gjykatës Administrative Vlorë është absurd dhe tërësisht arbitrar. "Ky vendim



Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi

me hije të forta korruptive, bëhet edhe më shumë pis, pasi për të njëjtin proces gjyqësor, me të njëjtin objekt ankimi, e njëjta gjykatë dhe i njëjti gjyqtar, i ka dhënë të drejtë vetëm 2 nga 9 subjek-

tet (të gjitha në shkelje të ligji) që kishin kundërshtuar revokimin e lejes mjedisore. Në vendim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë: ka vendosur "Pranimin e masës së sig-

urisë për dy aktpadi, nga 9 të tilla që ishin paraqitur pranë saj. Kjo do të thotë me fjalë të tjera: se gjykata deri në shqyrtim në themel të çështjes, i jep të drejtë këtyre dy subjekteve të vijnjë

PEZULLIMI
Pezullimi dhe revokimi i lejeve mjedisore për këtë aktivitet që kishte shkaktuar as më shumë e as më pak, por një katastrofë të vërtetë natyrore, u morr në zbatim të plotë të ligjit. Mes shumë të tjerash, dy shkeljet më të rënda të konstatuara ishin: ndryshimi i koordinatave të gërmimit nga leja në terren dhe e dyta: mungesa e zbatimit të detyrimit ligjor për rehabilitimin e zonës së gërmuar.

dhe me të njëjtin objekt ankimi, gjykata ka rrëzuar kërkesën e tyre? Pikëpyetja jetëshme dhe më e rëndësishme: si ka mundësi që për këtë subjekt (foto e printuar nga koordinatat), ku duket qartë ndryshimi i koordinatave, gjykata i ka dhënë të drejtë të vijojë biznesin barbar të guroretve në Malin e Tomorit?", deklaroi Klosi para mediave. Megjithatë ministri Klosi siguroi qytetarët se ministria që ai drejton do të vazhdojë luftën dhe përpjekjet për zbatimin e ligjit - tha Klosi. Ndërkohë ministri Klosi deklaroi se dhe kjo zonë ku janë bërë gërmimet, fshati Novaj do të jetë pjesë e Parkut Kombëtar të Tomorit, duke zgjeruar kufijtë e këtij parku. Ndërkohë është shpallur Park Natyror Lugina e Zagorisë dhe së shpejti do të shpallet Peizazhi i Mbrojtur dhe Mali i Krujës.

Qendra sociale në Tiranë

Rehabilitim dhe riintegrimin për fëmijët në konflikt me ligjin



Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj dhe ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, dje në qendrën sociale

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj dhe ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit për zbatimin e masave alternative të shmangies nga ndjekja penale e të miturve në konflikt me ligjin. Veliaj shprehu mirënjohjen për Ministrinë e Drejtësisë që mundësoi një marrëveshje të tillë, ndërsa shtoi se kjo metodë shërben për rehabilitimin e fëmijëve. "Jam i lumtur që i besuat Bashkisë së Tiranës, si institucioni i parë që eksperimenton dhe sjell një risi në pesë qendrat tona sociale, ku shumë prej atyre që sistemi i drejtësisë i konsideron se kanë kryer vepra të lehta, që mund të rehabilitohen fare mirë në qendrat sociale, të kenë mundësi ta bëjnë këtë këtu. Të rinjtë që ju do të referoni në shërbimet tona nuk do të jenë pjesë e ndonjë institucioni, jo të disa kangjellave, as të një hapësire me katër mure, por të një përvoje që fillon nga socializimi me këshilltarë e psikologë, tek puna me drejtues dhe mentorë në komunitet, që mund t'i përfshijnë në punë të tjera komunitare", tha Veliaj. Ministria e Drejtësisë, Etilda

Gjonaj tha se kjo marrëveshje krijon mundësi me bashkëkohore për trajtimin e fëmijëve që kanë probleme me ligjin. "Kjo qendër mund të konsiderohet si dallëndësja e parë e një vargu qendrash sociale në Tiranë dhe në të gjitha bashkitë e tjera të vendit, ku të miturit me dënime alternative, do të kenë mundësinë të trajtohen, ashtu siç marrin shërbimin dhe trajtimin në kategori fëmijësh. Marrëveshja që po nënshkruajmë ka vlerën e gurit të themelit në një sistem të ri, krejtësisht bashkëkohor që ne jemi

duke ndërtuar për drejtësinë për të miturit. Është një proces, i cili përbën një risi jo vetëm për vendin tonë, por njëkohësisht edhe për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Për herë të parë të miturit në kontakt me organet e drejtësisë trajtohen jashtë institucioneve të mbyllura, jashtë burgjeve, por në mjedisë miqësore, ku do të kenë mundësi të korrigjohen, këshillohen, informohen dhe udhëzohen se si mund të përmirësojnë sjelljen, se si mund të riparojnë dëmin e shkaktuar", tha Gjonaj.



Shëndeti gjatë 2017-ës

Çdo shqiptar është vizituar të paktën tri herë te mjeku

Të paktën tri herë në vit çdo shqiptar është vizituar nga mjeku gjatë vitit 2017. Sipas të dhënave të INSTAT në vitin 2017, numri i vizitave gjithsej në shërbimin parësor është mbi 7 milionë. Numri i vizitave në konsultorin e fëmijëve, gjatë vitit 2017, ka qenë më i lartë se numri i vizitave në konsultoren e gruas. Ditët mesatare të qëndrimit të një pacienti në spital janë 5,4 gjatë vitit 2017 nga 5,3 ditë në vitin 2016. Ndërrhyrjet kirurgjikale të kryera në spitalet publike janë 57.475 me një rritje prej 10%. Në vitin 2017, numërohen 413 qendra shëndetësore ndërkohë që kontakti për pacientë në shërbimin parësor është 2,7 herë, e thënë ndryshe çdo banor në Shqipëri, gjatë vitit, ka kontaktuar qendrat e kujdesit shëndetësor parësor mesatarisht 3 herë. Në vitin 2017, numri i spitaleve publike dhe jopublike në vend është 55, ku 42 janë spitale shtetërore dhe 13 spitale private. Mbulimi i shërbimit spitalor publik dhe jopublik është 2 spitale për 100 mijë banorë dhe numri i shtretërve spitalorë publike dhe jopublike është 8.885 (3 shtretër për 1000 banorë).

VIZITAT
Numri i vizitave në konsultorin e fëmijëve, gjatë vitit 2017, ka qenë më i lartë se numri i vizitave në konsultoren e gruas. Ditët mesatare të qëndrimit të një pacienti në spital janë 5,4 gjatë vitit 2017 nga 5,3 ditë në vitin 2016.

PAGESA



Kospiri: Skemë e re vlerësimi për përfituesit

Paralelisht, në mbledhjen e së martës, komisioni i Ekonomisë miratoi shtesinë e huasë prej 11 milion euro nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e cila synon modernizimin e skemës së asistencës sociale. Zv. ministria e Shëndetësisë, Bardhylka Kospiri paralajmëroi rishikim të formës së përfitimit të pagesës për aftësinë e kufizuar. Marrëveshja bazë për modernizimin e asistencës sociale kapte vlerën e 38 milion eurove, ndërkohë që shtesa e fondit prej 11 milion euro, përmes ndërhyrjeve që do të realizohen synon përdorimin me efektivitet në fondeve buxhetore dhe heqjen e abuzuesve nga skema e ndihmës ekonomike.

Ahmetaj: Rriten konkurrueshmërinë në ekonomi

Shqipëria bëhet pjesë e zonës ekonomike për rajonin

Shqipëria mund të jetë konkurrueshme në tregun rajonal të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor, përmes dy sektorëve të veçantë: perimeve dhe metaleve, të cilat kanë edhe impaktin më të madh në ekonominë vendëse. Kështu ka deklaruar ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, teksa ka mbledhur këtë të martë Komitetin për Lehtësimin e Tregtisë. Sipas Ahmetajt, ekonomitë e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor janë të angazhuara për të krijuar një zonë ekonomike rajonale drejt të shumë mundësive, drejt

të tregtisë së kostove të tregtisë dhe minimizimit të pengesave jotarifore për lehtësimin e tregtisë së mallrave, harmonizimin e tregjeve të CEFTA-s me Bashkimin Europian dhe krijimin e mekanizmit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tregtare. "Qeveria shqiptare është në dialog me komitetin e donatorëve në Shqipëri për të lexuar një analizë të thelluar të çështjeve të identifikuar si bar-

riera të aksesit në treg. Madje, shumë shpejt do të kemi edhe një projekt të dedikuar për lehtësimin e tregtisë dhe krijimin e zonës së integruar ekonomike të rajonit që po realizohet me Bankën Botërore", deklaroi Ahmetaj. Ahmetaj ka theksuar se ekonomia shqiptare ka pasur progres në drejtim të zhvillimit të konkurrueshmërisë. "Iniciativat që lidhen me konkurrueshmërinë duhet të përforcohen.

Duhet të përforcohen njohuritë mbi avantazhet si brenda grupeve të synuara, ashtu edhe me publikun e gjerë. Qasja kombëtare duhet të shoqërohet edhe me qasjen sektoriale rajonale, me qëllim përshtatjen e faktorëve që ndikojnë në investime, që shpesh mund të arrijnë, sipas sektorëve edhe në nivel rajonal", theksoi ministri i Financave dhe Ekonomisë. Komiteti për lehtësimin e tregtisë është ng-



ritur vetëm pak kohë më parë, në funksion të ndryshimeve të kryera në marrëveshjen e njohur si marrëveshja e Marakeshit për rritjen e tregtisë globale, duke përfshirë lëvizjen dhe zhgodanimin e shpejtë të mallrave duke përfshirë edhe transitimin e mallrave.

Guvernatori takon përfaqësuesit e misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar

Ornela Manjani

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, zhvilloi një takim me përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar të kryesuar nga Jan Kees Martijn, shefi i misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar për Shqipërinë, në ambientet e Bankës së Shqipërisë. Ky takim u zhvillua në kuadër të shkëmbimit të vazhdueshëm të opinionëve dhe dialogut ndër-institucional.

TAKIMI

Takimi nisi me një ekspozitë të guvernatorit Sejko mbi zhvillimet kryesore ekonomike, me fokus të veçantë në sektorin financiar dhe atë bankar në Shqipëri. Guvernatori u shpreh se mjedisi makroekonomik është i qëndrueshëm dhe ofron kushte të përshtatshme për një rritje pozitive ekonomike. Të dhënat zyrtare tregojnë se ekonomia shqiptare u rrit me 4.45% në tremujorin e parë të vitit, rritje kjo e bazuar kryesisht në rritjen e prodhimit dhe të eksportit të energjisë elektrike. Ai theksoi se sektorët potencialë që pritet të luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike të vendit në të ardhmen janë zhvillimi i turizmit dhe i bujqësisë. Duke u ndalur tek zhvillimet financiare në vend, guvernatori Sejko theksoi se sistemi bankar shqiptar karakterizohet nga norma të larta likuiditeti dhe është i mirëkapitalizuar. Guvernatori u kushtoi rëndësi të veçantë masave të ndërmarrura nga Banka e Shqipërisë për ruajtjen dhe garantimin e stabilitetit të çmimeve në vend. Në këtë kontekst, ai njohu të pranishmit me vendimet e Bankës së Shqipërisë për inflacionin dhe kursin e këmbimit, ku theksoi se ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm valutës ka dhënë efekte pozitive dhe është pritur pozitivisht nga agjentët e tregut. Ruajtja e nivelit të inflacionit në 3% mbetet objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë dhe në këtë drejtim guvernatori



Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, gjatë takimit me përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar

Sejko u shpreh se, sipas parashikimeve të Bankës së Shqipërisë, inflacioni pritet të kthehet në objektiv brenda vitit 2020. Banka e Shqipërisë po ndjek një politikë monetare lehtësuese, e cila është transmetuar pozitivisht në tregje financiare. Gjatë këtij takimi, guvernatori i njohu përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe me rezultatet pozitive në kuadër të uljes së kredive me probleme. Të dhënat më të fundit tregojnë për një rënie të kredive me probleme në nivelin 13.3%, në muajin maj. Më tej ai i njohu edhe me projektin më të ri të Bankës së Shqipërisë në këtë drejtim, "Tirana Approach", i cili synon t'u japë zgjidhje kredive me probleme për kredimarrësit e mëdhenj. Një tjetër çështje me rëndësi e diskutuar gjatë këtij takimi ishte edhe konsolidimi i sistemit bankar dhe hyrja e aktorëve të rinj

në treg. Guvernatori Sejko u shpreh se këto ndryshime po kryhen sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. **SISTEMI I PAGESAVE** Modernizimi i sistemit të pagesave si dhe hyrja në fuqi e ligjit "Mbi rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë", ishte një tjetër çështje e diskutuar në takim. Nga ana e tij, Martijn vlerësoi punën e bërë nga Banka e Shqipërisë dhe bashkëpunimin e frytshëm ndërmyjet dy institucioneve. Ai gjithashtu theksoi se në sajë të politikave ekonomike dhe reformave strukturore të ndërmarrura ndër vite, zhvillimet që vendi ka pësuar janë të dukshme. Në përfundim, guvernatori Sejko shprehu falënderimet e tij për mbështetjen e vazhdueshme teknike të dhënë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar për Bankën e Shqipërisë.

FMN në Tiranë, Gent Sejko "raporton" për ekonominë

Ekonomia shqiptare u rrit me 4.45% në tremujorin e parë të vitit

Njoftim i shoqërisë Vodafone Albania Sh.A.

Të nderuar Klientë,

Vodafone Albania Sh.A. ju njofton se duke filluar nga data **24 Korrik 2018**, do të ofrojë katër plane tarifore te reja me vlefshmëri mujore për pajtimtarët me paspagesë si më poshtë:

Paketa 1	Paketa 2	Paketa 3	Paketa 4
5 GB Internet pa limit	10 GB Internet pa limit	15 GB Internet pa limit	20 GB Internet pa limit
2500 & 250 Minuta & SMS kombëtare	4000 & 400 Minuta & SMS kombëtare	Pa limit Minuta & SMS kombëtare	Pa limit Minuta & SMS kombëtare
Pa limit SMS drejt Vodafone	Pa limit SMS drejt Vodafone	Pa limit SMS drejt Vodafone	Pa limit SMS drejt Vodafone
100 Minuta Ndërkombëtare	200 Minuta Ndërkombëtare	300&50 Minuta Ndërkombëtare	400&100 Minuta Ndërkombëtare
2,500 Lekë/muaj me TVSH	4,800 Lekë/muaj me TVSH	8,400 Lekë/muaj me TVSH	11,800 Lekë/muaj me TVSH

Planet tarifore Mini Red, Red, Red Advantage, Red Premium, Red Elite nuk do të ofrohen më në treg.

Pajtimtarët me paspagesë të cilët kanë një kontratë pajtimi të vlefshme nuk do të preken nga ky ndryshim. Klientet e rinj dhe ata të cilët do të rinovojnë kontratën e tyre në dyqanet Vodafone do të mund të përzgjedhin vetëm një nga planet tarifore të përmendura më sipër.

Për më shumë informacion, vizitoni dyqanet Vodafone ose kontaktoni Shërbimin e Klientit 149.



Table with 5 columns: ID, Name, Surname, Address, Amount. Includes entries like 1468 KORCE GJELI GELESH 3000, 1476 KORCE PETRI THIMO 2200, 1478 KORCE FOTO POSTOLI 845, 1477 KORCE RESUL XHABEJ 7633, 1484 KORCE LLAZO SHKEMBI 2000, 1489 KORCE DEFRIM SHKEMBI 1500, 1494 KORCE BEQIR BASHILLARI 9811, 1508 KORCE SAJI 4000, 1498 KORCE BEKURAN SHAHINI 4846, 1472 KORCE AVNI BAZELI 7978, 1461 KORCE ADEM GURI 2220, 1483 KORCE MUSTAFA XHIHANI 3000, 1492 KORCE RAMADAN CEZMA 195, 1495 KORCE LLAZI RIZA 10193, 1464 KORCE BEGRI SELIMLLARI 7000, 1467 KORCE BARIQ AZO 1238, 1469 KORCE ALI SHKEMBI 1931 M, 1475 KORCE DHIMITER KAMBO 220, 1501 KORCE MUHAMERR DAIKO 3600, 1502 KORCE THEODOR NASI 240, 1503 KORCE PIRRO SHINDE 2000, 1506 KORCE NURIE AGOLLI 1500, 1506 KORCE SELAMI BEGOLLARI 3000, 1508 KORCE Xhevriko LAMCE 11551, 1509 KORCE MEHMET SKENDERASI 250, 1510 KORCE VANGJEL JATAGANI 1800, 1511 KORCE THOMA TILI 4090, 1512 KORCE BARDHYL CELO 12826, 1513 KORCE TRIVET XHEMJI 1000, 1514 KORCE KRISTO POJANAKU 10200, 1515 KORCE XHAFFERR NAROLLI 5500, 1517 KORCE RAZIM CENOLLI 4000, 1518 KORCE GAQO VELJANI 55, 1519 KORCE ETHEM ALI 2000 M 2, 1520 KORCE 5000, 1521 KORCE 350, 1522 KORCE TERA GELESH 660, 1523 KORCE VANGJEL TEODORI 500, 1525 KORCE 343, 1526 KORCE RIZA ALI 3000, 1527 KORCE MUHAMERR SALU MOS MIRATOJE KERKESEN, 1529 KORCE RAFAIL SPIRO DINELLARI 4000, 1530 KORCE VIOLETA KARAMUCA 1600, 1531 KORCE ISAT ASAHELLA 1000, 1532 KORCE TRENDAFILE KOSALI 260, 1534 KORCE LUTFI KODRA 1050, 1535 KORCE 10000, 1536 KORCE 375, 1537 KORCE 372, 1538 KORCE VIKTOR KAPXHILLARI 3875, 1539 KORCE 1200, 1540 KORCE 1000, 1542 KORCE VLADIMIR SULEJMANI 6591, 1543 KORCE ROBERT MADHI 6000, 1544 KORCE BESNIKE SEJDARASI 3000, 1545 KORCE 24939, 1546 KORCE 2500, 1547 KORCE 625, 1548 KORCE 2615, 1550 KORCE 2583, 1551 KORCE 803, 1552 KORCE 900, 1554 KORCE 4000, 1555 KORCE 1000, 1556 KORCE 536, 1557 KORCE 1800, 1558 KORCE 546, 1559 KORCE MOS MIRATOJE KERKESEN, 1560 KORCE 6460, 1562 KORCE 5545, 1563 KORCE 1860, 1564 KORCE 870, 1565 KORCE 5702.5, 1567 KORCE MOS MIRATOJE KERKESEN, 1568 KORCE 10200, 1569 KORCE MOS MIRATOJE KERKESEN, 1570 KORCE 1000, 1571 KORCE 308, 1573 KORCE 900, 1574 KORCE MOS MBAYTIE KERKESEN, 1576 KORCE 3053, 1577 KORCE MOS MIRATOJE KERKESEN, 1578 KORCE 650, 1579 KORCE 4000, 1580 KORCE MOS MIRATOJE KERKESEN, 1581 KORCE 300, 1582 KORCE 750, 1583 KORCE 570, 1584 KORCE 7525, 1585 KORCE 947, 1586 KORCE MOS MIRATOJE KERKESEN, 1587 KORCE 1700, 1588 KORCE 3000, 1590 KORCE MOS MIRATOJE KERKESEN, 1591 KORCE 1050, 1592 KORCE 3745, 1593 KORCE 185, 1595 KORCE 1150, 305 KORCE 4000, 304 KORCE 900, 303 KORCE 1150, 301 KORCE 300, 300 KORCE 298, 298 KORCE 297, 296 KORCE 295, 295 KORCE 6060, 291 KORCE 13710, 292 KORCE 2161, 308 KORCE 9519, 306 KORCE 1165, 302 KORCE 6638, 294 KORCE 1195, 310 KORCE 1195, 307 KORCE 300, 483 KORCE 500, 481 KORCE 300, 485 KORCE 5073, 475 KORCE 4850, 473 KORCE MOSNIOHIE PRONESE, 471 KORCE 5680, 472 KORCE 5000, 484 KORCE 120, 480 KORCE 1165, 482 KORCE 6638, 478 KORCE 6630, 477 KORCE 6630, 476 KORCE 1195

Table with 5 columns: ID, Name, Surname, Address, Amount. Includes entries like 477 KORCE 10050, 486 KORCE 560, 487 KORCE 6000, 488 KORCE 3884, 489 KORCE 4657, 490 KORCE 2652, 491 KORCE 1100, 492 KORCE 996, 493 KORCE 900, 494 KORCE 10580, 495 KORCE 2000, 496 KORCE 4000 TRAJTUAR VETEM TOKA TRUALL, 497 KORCE 5834, 498 KORCE 1500 NE DOSJE NDDODHET EDHE 1505 DT 23.11.1998 IPA VULOSUR PER TE NIJETIN PRONE EDHE PER TE NIJETIN SUBJEKT, 499 KORCE 4068, 500 KORCE 2109, 503 KORCE 240, 501 KORCE 2109, 512 KORCE 4988, 509 KORCE 4750, 507 KORCE ULRIM HYMETI 1800, 511 KORCE 7430, 514 KORCE 3000, 502 KORCE 1191, 505 KORCE 8520, 508 KORCE 650, 509 KORCE 11 900, 510 KORCE 4150, 513 KORCE 4150, 515 KORCE 1250, 516 KORCE 3332, 522 KORCE 1340, 527 KORCE 3620, 528 KORCE MEHMET HOXHALLARI 3107 E drejte e paraberites per sip. 629, 523 KORCE 1060, 528 KORCE 3875 truall, 518 KORCE 3725 truall, 517 KORCE 2200, 530 KORCE 1340, 526 KORCE SULEJMAN NIAS AULI SHikemi Meralli 1160, 413 KORCE Shender 2000, 411 KORCE Pasho 100, 424 Korce 2200, 415 Korce 1190, 425 Korce 3000, 423 Korce 650, 422 Korce Alibashi, 421 Korce 3875 truall, 419 Korce 3725 truall, 412 Korce 11 900, 414 Korce 4150, 417 Korce 1250, 416 Korce 3332, 418 Korce Vangjeli Kote, 426 Korce Xheviti Nasufi 1160, 427 Korce Fiza Selim Veliu 2000, 428 Korce Jovan Pani 100, 430 Korce 2200, 431 Korce Rabihan Lengu Mos miratim kerkese, 432 Korce 1340, 433 Korce 3620, 435 Korce Thanas Kalço 1500 truall, 439 Korce 3107 E drejte e paraberites per sip. 629, 437 Korce 1060, 438 Korce 3875 truall, 439 Korce 3725 truall, 444 Korce 2200, 445 Korce 1190, 449 Korce 3000, 450 Korce Dhimitraq Postoli 1160, 453 Korce Themistokli Kalvani 2000, 448 Korce 1190, 442 Korce 3000, 452 Korce Cara Ilir Givibegaj, 447 Korce E drejte paraberite ose kompensim, 443 Korce 1160, 446 Korce 3000, 454 Korce Muhamet Gazimilani, 453 Korce Nenti Gaqi Ligori, 451 Korce Fani Zdruli, 441 Korce 2697, 463 Korce Kamber cenko, 462 Korce 1160, 464 Korce 2000, 467 Korce 11 503, 469 Korce Petref Dilka 12 240, 468 Korce Gezim Bala 642, 470 Korce 2200, 467 Korce Behar Koçibelli, 465 Korce 1600, 468 Korce Festim Elmaz Sejddalli 3250, 469 Korce Valter Dilka 1502, 461 Korce Sotir Mita Gode 5570, 460 Korce Demirali Dilka 10 746, 469 Korce Vangjeli Saqellari, 346 2200, 347 Shendet Shytlla, 348 KORCE 1600, 299 KORCE 3250, 350 KORCE 1502, 351 KORCE 200, 352 KORCE VASFI ZEQQ 11774, 353 KORCE 3000, 354 KORCE 600, 355 KORCE NAZUKO TEFIKU 400, 356 KORCE 1000, 357 KORCE SULEJMAN LICO 1000, 358 KORCE ALEKO STOJA 1500, 359 KORCE 2000, 360 KORCE 1054, 361 KORCE SELIM ZHILLA 800, 362 KORCE 652, 363 KORCE 1500, 364 KORCE 935, 365 KORCE 2171, 367 KORCE 3320, 366 KORCE 3501, 370 KORCE 1195, 379 KORCE 1460, 373 KORCE 4740, 376 KORCE 1195, 369 KORCE 1195, 378 KORCE 6630, 374 KORCE VIKTOR SHKEMBI 258

(vijon)

Dialogu Kosovë-Serbi, ja cilët krerë kosovarë do jenë të pranishëm

Sot takimi Thaçi-Vuçiç në Bruksel, çfarë pritet të ndodhë

Ndërmjetëson BE-ja por opozita mungon, Delawie: Punoni së bashku

Ditën e sotme, "ekipi gjithëpërfshirës i Kosovës për dialog me Serbinë", por pa opozitën, takohet në Bruksel me shefen e diplomacisë evropiane, Federika Mogherini. Thaçi i vetëm takohet me Vuçiçin. Të gjithë udhëheqësit më të lartë të institucioneve të Kosovës udhëtojnë në Bruksel sot, në ditën kur presidenti Hashim Thaçi, takohet me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiç, në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Njoftimi për delegacionin e gjerë të Kosovës që udhëton për në Bruksel vjen nga qeveria e Kosovës, delegacion ky që duket të jetë "ekipi gjithëpërfshirës për dialog me Serbinë", por për momentin pa prezencën e opozitës kosovare. "Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, zëvendëskryeministri i parë dhe ministër i Jashtëm, Behgjet Pacolli, zëvendëskryeministri Fatmir Limaj dhe zëvendëskryeministri dhe ministër për Diasporë dhe Investime Strategjike, Dardan Gashi, në një takim të përbashkët, vendosën që të mërkurën, më 18 korrik, të takojnë Përfaqësuesen e Lartë të Bashkimit Evropian, znj. Federika Mogherini në Bruksel. Udhëheqësit e institucioneve të Republikës së Kosovës, do t'i konfirmojnë znj. Mogherini përkushtimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për dialogun me Serbinë dhe po ashtu përkushtimin dhe angazhimin tyre për përfshirjen e opozitës në dialog, respektivisht krijimin e një ekipi gjithëpërfshirës", thuhet në një njoftim të qeverisë së Kosovës. Pas takimit me



GREG DELAWIE

"Nuk ka alternativë tjetër përveç dialogut dhe Kosova duhet të jetë e gatshme. Punoni së bashku tani për një ekip gjithëpërfshirës, ekspertësh dhe konsensual. Fokusohuni në qëllimet e qarta afatgjatë të Kosovës", shkroi në një postim në 'Twitter' Greg Delawie.

RAMUSH HARADINAJ

"Mbështetja e SHBA-ve në proceset nëpër të cilat po kalon vendi, liberalizimi i vizave, finalizimi i dialogut me Serbinë dhe anëtarësimi në BE dhe NATO është jetike për Kosovën dhe qytetarët e saj", - tha Haradinaj.

PJESËMARRËSIT NGA KOSOVA

"Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi; kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli; Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj; zëvendëskryeministri i parë dhe ministër i Jashtëm, Behgjet Pacolli; zëvendëskryeministri Fatmir Limaj dhe zëvendëskryeministri dhe ministër për Diasporën dhe Investime Strategjike, Dardan Gashi", - njofton qeveria.

cioneve të Republikës së Kosovës për dialogun me Serbinë dhe po ashtu përkushtimin dhe angazhimin tyre për përfshirjen

e opozitës në dialog, respektivisht krijimin e një ekipi gjithëpërfshirës", thuhet në një njoftim të qeverisë së Kosovës. Pas takimit me

shefen e diplomacisë evropiane Federika Mogherini, merret vesh se nga delegacioni i gjerë i Kosovës, në tavolinën e bisedimeve me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiç, do të marrë pjesë vetëm presidenti Hashim Thaçi. Partitë politike opozitare s'po pranojnë të jenë pjesë e ekipeve gjithëpërfshirës në dialog me Serbinë që po e kërkon me çdo kusht presidenti i Kosovës. Madje njëra nga partitë opozitare, krahu i ndarë i lëvizjes Vetëvendosja, Partia Social Demokratike, po mbledh nënshkrimet për një seancë të jashtëzakonshme në përpjekje për të parandaluar presidentin që ta udhëheqë dialogun me Serbinë. Ndërkohë, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, përmes një platforme për dialog kërkon konsensus politik. Kryetari i kuvendit Kadri Veseli, i ka bërë thirrje opozitës që t'i bashkohet këtij karvani. Në përgjigje të këtyre akuzave, shefi i grupit parlamentar të LDK-së, Avdullah Hoti, thotë se para se Kosova të hyjë në fazën finale të dialogut me Serbinë, këtu duhet të mbahen zgjedhje të parakohshme, sepse sipas tij, këto institucione nuk kanë legjitimitet, sepse partitë në pushtet nuk janë shumicë në parlament. Një ekip gjithëpërfshirës të Kosovës, ekip konsensual për dialog me Serbinë po e kërkon edhe ambasadori amerikan në Kosovë, Greg Delawie. "Nuk ka alternativë tjetër pos dialogut dhe Kosova duhet të jetë e gatshme. Punoni së bashku tani për një ekip gjithëpërfshirës, ekspertësh dhe konsensual. Fokusohuni në qëllimet e qarta afatgjatë të Kosovës", shkroi në një postim në Twitter Greg Delawie. "Mbështetja e SHBA-së në proceset nëpër të cilat po kalon vendi, liberalizimin e vizave, finalizimin e dialogut me Serbinë dhe anëtarësimin në BE dhe NATO është jetike për Kosovën dhe qytetarët e saj", tha Haradinaj. Bashkimi Evropian po kërkon një mënyrë që Serbisë t'i hapet rruga për anëtarësim, ndërsa Kosova të vazhdojë të njëjtën rrugë, por fillimisht në përbushjen e kritereve që dalin nga marrëveshja e stabilizim asociimit (MSA) e nënshkruar në tetor të vitit 2015 ndërmjet BE-së dhe Kosovës.



Ish-truproja i Bin Ladenit po trazon një vend të tërë, Gjermania s'e dëbon dot

Prej kohësh tashmë rasti i Sami A. po trazon Gjermaninë. Tuniziani i përfolur si truproja e Bin Ladenit ka jetuar me familjen me ndihma sociale. Dëbimi i tij, i shtyrë me vite u krye, por tani ai duhet të rikthehet në Gjermani. Sami A. i dyshuar si truproja e Osama Bin Ladenit, islamist, i kategorizuar nga autoritetet gjermane si "i rrezikshëm", pra që mund të kryejë atentate terroriste jeton prej vitesh në Gjermani, në Bochum me gruan dhe fëmijët duke marrë kontributet sociale të shtetit. Ai njihet si predikues salafist. Në vitin 2000 me gjasë ai ka marrë pjesë në një trajnim luftarak në kampet e Al-Kaidës në Afganistan dhe pjesërisht ka bërë pjesë edhe në truporjen e Osama Bin Ladenit. Këto akuzat Sami A. i ka hedhur gjithmonë poshtë. Ndaj tij ishte hapur një procedurë penale në Gjermani, por shkak të mungesës së provave, ajo ishte pezulluar sërisht. Kërkesa e Sami A. për azil ishte refuzuar prej kohësh, ai duhet të dëbohet nga Gjermania që në vitin 2014, por për shkak se në Tunizi atë e kërcënonte tortura, dëbimi i tij ishte shtyrë. Pas heqjes së ndalimit të dëbimit në qershor 2018 ai u kalua në paraburgim para dëbimit. Në një aksion të shpejtë tuniziani arriti të dëbohej në vendlindje të premtën e kaluar dhe u dorëzua autoriteteve në vend. MB e konfirmoi dëbimin. Por një gjykatë gjermane kërkoi ta zhbëjë dëbimin dhe kthimin e tij në Gjermani për shkak të shkeljeve juridike, shkruan "DW". Sami A., ashtu si edhe vite më parë kundër dëbimit u mbrojt me një kërkesë të shpejtë në Gjykatën Administrative në Gelsenkirchen. Kjo gjykatë e gjykoji të enjten dëbimin si "shkelje të rëndë të ligjit dhe parimeve bazë të shtetit ligjor". "Nuk ka garanci diplomatike të qeverisë tuniziane, që ai nuk kërcënohet nga tortura. Prandaj ai duhet të kthehet në Gjermani," tha gjykata përkatëse. Por ndërkohë vendimi i gjykatës mbërrin tek autoritetet përgjegjëse, të premtën në mënjens, në një kohë kur avioni me Sami A. ishte ngritur në ajër. Zyra e të huajve në Bochum si edhe Ministria e Refugjatëve në Haudin Renani Veriore-Vestfali do të bëjnë ankimum kundër këtij vendimi. Nga ana e saj drejtësia tuniziane bëri të qartë, se kompetencën për Sami A. tani e ka ajo. "Ky rast i përket drejtësisë tuniziane", bëri të ditur një zëdhënës i prokurorisë anti-terrore.

SHKURT

Samiti me Rusinë, Trump kritikohet pas takimit

Pasi presidenti i SHBA-së, Donald Trump mbrojti Rusinë në lidhje me pretendimet e ndërhyrjes në zgjedhjet e 2016-ës, nuk kanë munguar një breshëri kritikash në SHBA. Në një samit me presidentin rus, Vladimir Putin, në Finlandë, Trump kundërshtoi agjencitë e inteligjencës amerikane, duke thënë se Rusia nuk kishte arsye për të ndërhyrë. Kreu i republikanëve në Kongres, Paul Ryan, tha se Trump duhet të kuptojë se "Rusia nuk është aleati ynë". Shefi i inteligjencës së presidentit gjithashtu u shpreh i zemëruar. Rusia është përgjegjëse për "përpjekjet e vazhdueshme dhe të përhapura" për të minuar demokracinë amerikane, tha në një deklaratë Drejtori i Shërbimit Kombëtar të Inteligjencës, Dan Coats. Presidentët e SHBA dhe Rusisë mbajtën të hënën rreth dy orë bisedime kokë më kokë, pa këshilltarët e tyre në kryeqytetin finlandez Helsinki. Në një konferencë shtypi pas samitit, ai u pyet nëse ai besonte agjencitë e tij të inteligjencës ose presidentin rus, kur ai erdhi në akuzat për ndërhyrje në zgjedhje. "Presidenti Putin thotë se nuk është Rusia. Unë nuk shoh ndonjë arsye pse do të ishte ajo", u përgjig ai. Trump, gjithashtu, fajsoi për marrëdhëniet e dobëta me Rusinë në administratat amerikane të kaluara dhe jo veprimet ruse.

INDONEZI/ ZEMËROHEN BANORËT, VRASIN 292 KROKODILË

Një ngjarje e çuditshme ka ndodhur në një vend të largët të Indonezisë. Pas vdekjes së një personi si pasojë e sulmit të një krokodili, banorët e një rajoni kanë vrarë 292 krokodilë që ndodheshin në fermë në Indonezi. Sipas lajmit të gazetës "Kompas", 48 vjeçari Sugito nga rajoni Sorongi i provincës Papua Perëndimore ka humbur jetën si pasojë e sulmeve të krokodilëve në fermë, ku kishte shkuar për të mbledhur bar për kafshët e tij.



SHMANGNI PASOJAT NEGATIVE TË QËNDRIMIT ULUR

SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETIA SHQIPTARE

E mërkurë 18 Korrik 2018



MODELJA
E NJOHUR

**Oriola Marashi 'çmend' pushuesit,
shfaqet me bikini super të vogla**




**Era në skena të nxehta me një
xhamajkan në klipin e ri**

**BULEVARDI
POLITIK**



- "Performancë turpëruese"... mediat sociale masakrojnë Trump me meme pas takimit me Putin...
- Festë në Velipojë, Luan Rama befason edhe si këngëtar
- Humori i ish-këshilltarit të Berishës: Në plazh pa gruan
- U përjashtua nga dekriminalizimi, deputetët socialistë kafe me Arben Ndokën



Reëfhet këngëtar: Koha mes muzikës dhe modelingut, projektet e fundit

ALBAN RAMOSAJ: Në "Live" më vlerësojnë ritmin e brendshëm

"Skena, qëllimi im në jetë për të qenë argëtues"

Rrëfëhet këngëtari: Koha mes muzikës dhe modelingut, projektet e fundit

Alban Ramosaj:

Në "Live" më vlerësojnë ritmin e brendshëm

"Skena, qëllimi im në jetë për të qenë argëtues"

Egla Xhemali


Ai është një nga këngëtarët më të dashur dhe më simpatik në Shqipëri. Bëhet fjalë për Alban Ramosajn, i cili këtë herë vjen në një rrëfim ndryshe për suplementin "Summer Pages" të "Gazeta Shqiptare". Kjo verë e ka gjetur këngëtarin të impenjuar me muzikën, si dhe me modelingun që i rrëmben një pjesë të mirë të kohës. Albani na pohon se është siguri e madhe shpirtërore kur ndan me motrën të njëjtin pasion, pasi në këtë mënyrë mbështesin njëri-tjetrin. Për të performancat live janë të shenjta, pasi nëpërmjet tyre tregojn veten dhe se vlerësohet për ritmin e brendshëm. Nëse nuk do të ishte këngëtar ai do zgjidhte të bëhej aktor, regjisor, fotograf, si dhe prezantues, megjithëse është mjaft entuziast për profesionin dhe pasionet që ka. I pyetur se me cilin artist me famë botërore do të bënte duet, Ramosaj zgjedh Sian. Së fundmi, Albani na zbulon projektet e tij në muzikë. Për të gjithë fansat do ketë surpriza tepër të këndshme muajt në vijim.

SI KA NISUR VERA PËR ALBANIN?

Me shumë punë, momentalisht jam në punime të disa këngëve të reja dhe xhirimeve të tyre.

KU PO I KALONI PUSHIMET?

Në pamundësi kohore nuk i kam filluar akoma, plane kam me shoqërinë që të vizitojmë disa vende të ndry-



shme nga gushti.

CILI ËSHTË AKTIVITETI QË E RRËMBEN MË SË SHUMTI KOHËN TUAJ?

Kohëve të fundit modelingu, përveç kësaj të fundit dhe sesionet në studio ku jam shumicën e kohës duke shkruajtur për vete dhe për artistë të tjerë.

SI FILLON NJË DITË E ZAKONSHME PËR ALBA-

NIN?

Nuk kam një ditë të zakonshme, më ndryshojnë dita ditës, po zakonisht me telefonin të bombarduar nga mesazhet. (gesh)

ÇFARË NDJESIE ËSHTË QË NDANI TË NJËJTIN PASION PËR MUZIKËN ME MOTRËN TUAJ?

Siguri shpirtërore në një sens, të dish thellë brenda teje që në çdo rast mund të mbështetemi tek njëri-tjetri.

JENI NJË NGA KËNGËTARËT MË TË DASHUR PËR PUBLIKUN SHQIPTAR. ÇFARË E BËN TË VEÇANTË ALBANIN?

Faleminderit si fillim, besoj që të qenit vetja jote të bën të veçantë, s'ka dy si ty.

SI DO I PËRKUFIZONIT PERFORMANCAT LIVE?

Sa herë që shkel në skenë për të performuar e rikuptoj që është arsyeja dhe qëllimi im në jetë për të qenë një argëtues. Me hapet mundësia që të jem 110% vetja ime dhe të vlerësohem për ritmin e brendshëm që kam.

PËR ÇDO KËNGËTARË TË GJITHA KËNGËT E TJJ JANË TË SHENJTA. CILËN NGA KËNGËT TUAJA DO VEÇONIT MË TEPËR?

Secila këngë është e veçantë në mënyrën e vet për mua, varet nga

gjendja emocionale. Nëse i dëgjoni këngët e mia mund të kuptoni që kam zhanre dhe gjendje emocionale të ndryshme ndaj dhe s'mund t'i krahasoj, por momentalisht mund të them që "Ike" është kënga, të cilën e luaj pak më shpesh.

PËR SA KOHË MUND TË RRI ALBANI PA MUZIKË?

Jam në çdo moment i shoqëruar nga muzika, duke e dëgjuar, duke kënduar ose duke e shkruar.

NËSE DO U JEPEJ MUNDËSIA, ME CILIN KËNGËTARË ME FAMË BOTËRORE DO KISHIT BËRË NJË DUET?

SIA.

NDRYSHË NGA KËNGËTARËT E TJERË JU KENI NJË STIL TË VEÇANTË NË TË VESHUR. A LIDHET KJO ME KARAKTERIN TUAJ?

Sigurisht, veshja është një përzgjedje e personalitetit dhe karakterit të një individi.

CILAT JANË PROJEKTET TUAJA PËR KËTË VERË?

Jam paksa në dilemë nga fakti që kam shkruajtur më shumë se ç'duhet dhe jam në përzgjedhje të projekteve, është gjë e mirë, por dhe problematike.

NËSE NUK DO ISHIT KËNGËTAR, ÇFARË PROFESIONI TJETËR DO KISHIT ZGJEDHUR?

Aktor, regjisor, fotograf, prezantues mbase? Nuk e di, jam shumë i lumtur me profesionin dhe pasionet që kam.

ÇDO ARTIST I SUKËSSHËM ËSHTË NË NJËFARË MËNYRË SHEMBULL PËR PUBLIKUN. CILA DO TË ISHIT KËSHILLA JUJ PËR TË RINJTË?

Ndajni ëndrrat, jini vetvetja dhe jetoni një jetë ku në momentet e fundit të saj të keni një buzëqeshje në fytyrë.



Oriola Marashi 'çmend' pushuesit, shfaqet me bikini super të vogla

Oriola Marashi është një ndër personazhet më të komentuar në mediat rozë. Modelja merr gjithmonë vëmendjen e fansave me fotot provokuese që publikon herë pas herë në profilin e saj në "Instagram". Duket se bukuroshja ka nisur pushimet. Ajo ka qenë shumë aktive në rrjetet sociale ditët e fundit ku dhe ka publikuar momentet e relaksit me shoqërinë. Së fundmi, Oriola ka çmendur rrjetin me foton e nxehtë që ka publikuar në "Instastory". Modelja shfaqet afër bregdetit me një gotë shampanjë në dorë, duke ekspozuar format bombastike e veshur me një palë bikini të vogla.



Era në skena të nxehta me një xhamajkan në klipin e ri




Këngëtarja shqiptare Era Istrefi pas performancës së saj në finalen e "Kupës së Botës", duket se nuk ka ndërmend të ndalojë. Ajo prej kohësh ka lajmëruar se është duke punuar për klipin e këngës më të re që titullohet "Prisoner". Siç u bë e ditur klipi i këngës është xhiruar në Xhamajka dhe të gjithë kanë qenë kurioz të shikonin përfundimin e tij. Era i ka dhënë fund pritjes dhe ka publikuar këngën më të re. Në të këngëtarja shfaqet përkrah një djali nga Xhamajka në skena të nxehta, ku herë duken si të dashuruar dhe herë zihen. "Jam rritur duke dëgjuar këngë reggae, kështu që kur e dëgjova demon e "Prisoner" të shkruar nga Emily Warren dhe Scott Harris, e ndjeva që ishte shumë e përshtatshme për mua, u identifikova me melodinë dhe tekstin e mrekullueshëm. Muzikën reggae fillova ta pëlqej që në moshën 16-vjeçare dhe kjo më bëri që të shkoj në Jamaica për ta xhiruar videoklipin", ka thënë ajo për faqen e famshme "Just Jared".



Me rroba banje e tepër tërheqëse, Soni Malaj zbulon setin e ri fotografik

Në shijen e suksesit në muzikë, pas arritjeve të njëpasnjëshme në tregun latin, me dy hitet e saj të fundit, ajo po na tregon se pikësynimet janë të qarta sa i takon këngës dhe këtë po na e dëshmon me fakte. Jo vetëm tregu shqiptar i muzikës, por edhe ai latin duket se po e mirëpresin zërin e Soni Malajt, bashkë me stilin dhe imazhin e saj të kurrar. Bukuroshja në një zgjim të hershëm të saj, na ka treguar se nuk ka qenë deti dëshira parësore që e ka çuar atë drejt plazhit, por një tjetër motiv.



Soni po realizon një sesion të ri fotografik dhe imazhi i saj është tejet përvëlues. Me kostum banje, dhe në super formë fizike, këngëtarja na ka befasuar me hiret e saj. Me siguri, që foto të tjera nga seti do të publikohen në ditët në vijim, por deri atëherë le të shijojmë këto që kemi!

Morena Taraku tejet 'përvëluese', vallëzon në mes të shiut

Morena Taraku duket në çdo kohë dhe në çdo vend tërheqëse. Këngëtarja dhe modelja kosovare ka postuar në llogarinë e saj 'Instagram' një video teksa shihet duke vallëzuar në një fustan blu ngjitur për trupi në mes të shiut. "Më pëlqejnë njerëzit kur buzëqeshin edhe kur bie shi", ka shkruar bukuroshja. Ndryshe ajo këtë verë ka qenë më se e përfolur për lidhjen që nuk zgjati shumë me miliarderin iranian, Sasha Sobhanin.



Puna që kërkon të qëndroni ulur për një kohë të gjatë jo vetëm që shkakton dhimbje në pjesën e poshtme të shpinës, por edhe rrit rrezikun nga kanceri dhe sëmundjet e zemrës, kanë treguar dy studime të reja amerikane.

Por lajmi i mirë është që dhimbjeve të shpinës dhe pasojave më të këqija shëndetësore megjithatë mund t'u vihet fundi, dhe kjo me vetëdisiplinë në vend të punës. Çdo një orë çohuni nga karrigia dhe të paktën për pesë minuta bëni çka do, përveç se të qëndroni ulur.

Shkuarja në tualet, marrja e një gote ujë, shëtitja nëpër shkallë apo rreth ndërtesës janë hapat e parë në drejtim të përmirësimit të shëndetit. Do të ishte e shkëlqyeshme që çdo disa orë në punë të bëni disa ushtrime të zgjatjes. Por me e rëndësishme është, theksojnë mjekët, që pas punës të mos vazhdoni të qëndroni gjatë tërë mbrëmjes para televizorit.

Sa më aktiv të jeni në kohë të lirë, më të shëndetshëm do të jeni, thonë mjekët. E njëjta vlen edhe për ata të cilët ditën në punë e kalojnë në këmbë.

Femrat, të cilat qëndrojnë ulur nga tetë orë në ditë kanë rrezik më të madh nga zgjerimi i venave të gjakut.

Ushtrimet rekomandohen edhe për sëmundjen më të përhapur të njeriut modern, të punësuar - stresin.

Nëse ai është kronik, truri nxit sekrecionin e rritur të hormonit të kortizolit dhe noradrenalinës. Disa nga pasojat janë shtresat e akumuluar rreth belit, tensioni i rritur i gjakut, rreziku më i madh nga sëmundjet e zemrës.

Çfarëdo aktiviteti fizik do të zvogëlojë prodhimin e atyre hormoneve dhe do të relaksojë muskujt. Por, megjithatë rekomandohen ushtrime më intensive, siç është vrapimi. Ndihe me e madhe në luftë me stresin është edhe dëgjimi i muzikës, sepse zvogëlon tensionin dhe numrin e rrahjeve të zemrës, thonë mjekët.

MOS U KËRRUSNI KUR SHITYPNI NË TELEFON
Kërrusja gjatë shikimit në telefon po ashtu mund të ketë pasojat e rënda në qafë dhe në shpinë. Prandaj më së miri është që pajisjet të mbahen në nivel të syve



Shmangni pasojat negative të qëndrimit ulur



për të qëndruar trupi në pozitë sa më të drejtë, thonë mjekët. **SHTRESAT ERGONOMIKE PËR TASTIERË DHE MAUS RUAJNË NYJAT**
Ata të cilët shtypin shumë në tastierë duhet të marrin bazën ergonomike për tastierë dhe maus, e cila i lodh më pak nyjat. Pauzat e shpeshta po ashtu janë të domosdoshme, veçanërisht për femrat gjatë menstruacioneve, sepse atëherë grumbullohet më shumë

ujë në nyje, çka krijon shtypje në to. **KUR I NGRINI FËMIJËT, NDIHMOJENI VETEN ME KËMBË**
Edukatoret shpesh duhet t'i ngrënë fëmijët, çka mund të jetë shkak për dhimbjet në krahë dhe në shpinë. Mjekët u rekomandojnë edukatoreve në kopsht dhe nënave që derisa mbajnë fëmijët apo ndonjë barrë tjetër, ta kalojnë peshën edhe në këmbë.

USHQIMI NË SHTEPI SHPËTON
Njerëzit, të cilët punojnë në ndërtime të natës vuajnë më shpesh nga sindroma e irritimit të zorrëve se ata që punojnë ditën. **KARRIGIA NUK ËSHTË E PARREZIKSHME**
Nëse në punë rrini në këmbë dhe ecni shpesh, jeni më të mbrojtur nga sëmundjet e zemrës dhe nga trashësia për dallim prej atyre që qëndrojnë në karrige.

FUNDJAVA ËSHTË E REZERVUAR PËR MBUSHJE ME ENERGJI
Nëse punoni në ndërrime të natës, është e rëndësishme që gjatë ditës të flini 7-8 orë të mira. Për të krijuar kushte të mira për gjumë, uleni temperaturën e dhomës, lëshoni roletat, dhe vendosni tampona/tapë në veshë. Po ashtu gjatë ditëve të lira flini sa më shumë që mundeni.

"Performancë turpëruese"... mediat sociale masakrojnë Trump me meme pas takimit me Putin...

Gjatë konferencës për shtyp pas bisedimeve private që zgjatën më shumë se dy orë, Presidenti i SHBA-së, Donald Trump e habiti botën me një përgjigje ndaj një pyetje drejtuar tij rreth ndërhyrjes së Rusisë në zgjedhjet e SHBA. Ai u duk se i hodhi poshtë përfundimet e arritura nga agjencitë e inteligjencës amerikane, pasi Putin në fjalën e tij tha se Rusia nuk ndërhyri në zgjedhjet presidenciale. Kjo bëri që përdoruesit e mediave sociale të përmbysin 'Twitter' dhe 'Instagram' me meme që talleshin me Trump, shumë prej të cilëve e portretizojnë atë si një kukull që trajtohet si i tillë nga Putin... Daily Mail jep këtë përshkrim në një artikull të gjatë për këtë çështje, ku nuk mungojnë në faqen e saj edhe memet tallëse për Trump.



Festë në Velipojë, Luan Rama befason edhe si këngëtar

Është në mbrëmje të 14 korrikut, është shndërruar në festë në plazhin e bukur të Velipojës të Bashkisë së Shkodrës, teksa mijëra qytetarë nga Shkodra e jo vetëm, kanë marrë pjesë në përirimin e Grand Hotel Europa Resort, një investim i biznesmenit Agron Çela, njëherësh edhe deputet i LSI-së.

Mes të pranishmëve kanë qenë edhe përfaqësues të politikës, ku natyrshëm në shumicë kanë qenë deputetët e LSI-së, të prirë nga kryetarja e tyre zonja Monika Kryemadhi. Festa që ka vazhduar deri në orët e vona pas mesnatës, i ka ndezur të gjithë të pranishmit mes ritmeve të muzikës së bukur të këngëve qytetare shkodrane, me të cilat ka befason si këngëtar deputeti dhe zëvendëskryetari i LSI-së Luan Rama, i cili është rrembyer prej atmosferës festive të krijuar nga kolegët e partisë së tij, por edhe prej nostalgjisë së kohës kur ka qenë student në Universitetin "Luigj Gurakuqi" në Shkodër. Shumë prej të pranishmëve, të befason nga Luani këngëtar dhe me humorin e njohur shkodran, kanë shpejtuar "ta prenojnë" për sezonin e verës, meqë edhe parlamenti do të nisë pushimet.



BULEVARDI POLITIK

Në merrni seriozisht! 😊

Humori i ish-këshilltarit të Berishës: Në plazh pa gruan

Është tejet pikant në stilin e të shkruarit Ilir Kadia, ish-këshilltari i ish-kryeministrit Sali Berisha. Në një postim në 'Facebook', me titull: "Në plazh pa gruan", Kadia shkroi këtë fundjavë:

"U ndërrova shpejt e shpejt në makinë dhe dola i krekosur për herë të parë këtë vit me rroba banjo në breg të detit. Barkun e futa me thithje brenda, ndërsa krahët i hapa pak si trup trekëndësh. Flokët e dija që i kisha mirë se vetëm dy ditë më parë isha qethur. Dy vajza të reja topolake shikonin nga unë me shikëputje dhe qeshnin. Erdh kjo ditë që mos ua var, mendoja me kokën lart duke kujtuar kohën kur isha unë që nuk ua ndaja sytë duke i parë nga maja e kokës deri tek gishtat e këmbëve e duke ndalë vështrimin vende-vende. Vajzat vazhdonin të shihnin me shikëputje vetëm në një vend duke kukurisur. Kur vajta në çadër i hodha një vështrim të shpejtë trupit tim të lidhur me fije merimange dhe pashë se... i kisha veshur rrobat e banjoes mbrapsht!"



U përjashtua nga dekriminalizimi, deputetët socialistë kafe me Arben Ndokën

Ligji për dekriminalizimin arriti që gjatë legjislaturës së shkuar të largojë nga parlamenti një numër jo të vogël deputetësh të cilët kishin pasur me parë probleme me ligjin dhe që në bazë të këtij ligji ishin të papërshtatshëm për të qenë përfaqësues të popullit. Një prej tyre ishte edhe ish-deputeti i Lezhës, Arben Ndoka, i cili u detyrua të dorëzojë mandatin ndërsa Partia Socialiste ta përjashtonte nga radhët e saj. Por duket se akti i përjashtimit ka qenë vetëm formal, pasi Ndoka shpesh herë është parë në aktivitetet partiake të PS dhe të ketë kontakte dhe shoqëri të vazhdueshme me deputetët e saj. Ai sot është parë dhe fotografuar në shoqërinë e deputetëve Xhemal Qefalija dhe Pjerin Ndreu, si dhe të kreu të Zyrës Përmbarimore, Piro Lutaj. Kujtojmë që të katër personazhet e njohur gjatë legjislaturës së shkuar kanë qenë koleg në Komisionin e Sigurisë Kombëtare.



DEBATI

Arkitekti holandez: E njoh Edin nga Parisi, Shqipëria është për të qeshur

Fatmira Nikolli

Aleanca për Teatrin publikon leksionin që miku i kryeministrit u jep studentëve në Londër

Një kullë me imazhin e Skënderbeut? Një kullë me hartën e Shqipërisë? Një piramidë me lule? Një bllok pallatesh si "pas tërmetit"? Një gjë me historinë? Një gjë me babain e kombit? Kullat e ardhshme përreth qendrës dhe projektet e kahershme deri edhe për ish-ambasadën sovjetike, të rrëfyera nga një arkitekt i huaj përmes bisedave me kryeministrin e Shqipërisë.

"Në ora 7 n' Teatër do jepet një material filmik se si Edi Rama i VI-të, porositi kullat si pica me karçof, dhe arkitekti i oborrit i tregon historitë me kulla si barçaleta me çunat e lagjes. Në fakt, këto tregohen si barçaleta, po janë histori reale, histori 20-vjeçare e shkatërrimit të qytetit tonë, nga ca muhabete që ka bërë dikur Perandori me shërbëtorët e tij". Ishte ky njoftimi i së hënës, për programin e protestës së darkës, në ditën e saj të 35-të kundër shembjes së dy teatrove kombëtarë. Sheshi ishte si çdo ditë me rreth 150 protestues-disa që ka qenë të 35-a ditë e të tjerë që vijnë, ikin, rikthehen. Është muzg kur nis transmetimi i leksionit të Winy Maas, dielli ka perënduar ndërsa Aleanca dhe qytetarët kanë folur për vendosmëri e qëndrim në mbrojtjen e godinave të teatrove dhe truallit-kanë folur për ngujim, kanë recituar Ali Asllanin, kanë folur për korupsion, kanë pritur qytetarë që firmosin peticionin, kanë sqaruar kalimtarë që pyesin, kanë tjerë edhe njëherë anën ligjore bashkë me Çlirim Gjatën, kanë risqaruar pozicionet për takimin e famshëm me Erion Veliajn dhe kanë 'bërë be' se do të jenë aty, deri ditën e fundit.

Është muzg pra, kur nga sheshi, me një figurë të zbehtë e me një të folur të qartë sqarohet se ajo që do të shihet, është një rrëfim i mikut të kryeministrit, që tregon bisedat mes tyre ndër vite, biseda që shërbyen si fillesa për shndërrimin e Tiranës në atë që është sot.

Teksa jepte këtë sqarim, Ervin Goci i shoqërisë civile, lajmëronte



Arkitekti Winy Maas

për një material ku një arkitekt e urbanist në zë, Winy Maas, në një leksion dhënë studentëve të tij mbi arkitekturën flet edhe për Shqipërinë "vendin që është për të qeshur" e ironinë e BE-së, ku Britania del e Shqipëria hyn. Materiali, që gjendet edhe në Youtube, flet për kulla të reja afër qendrës së Tiranës, për kulla me hartën e Shqipërisë, për një ndërtesë forma e së cilës jep imazhin e Skënderbeut, për një resort turistik me investitor rus.

"Dokumentari që u shfaq në sheshin e Teatrit: Rama, porositi si i kullave. Winy Maas, një nga arkitektët e preferuar të Edi Ramës, ka mbajtur një leksion në një universitet në Londër përpara disa javësh (maj 2018). Aty ai shprehet lirshëm se si është Edi Rama, kryetar bashkie dhe kryeministër, që porositi kullat dhe ndërtimet në qytet. Nuk i kryejnë ndërtuesit apo pronarët e truallit, po vetë Rama që më pas i shpërndan si favore të klientët e tij. Konkursët janë të gjitha false. Së fundmi, vetë Rama ka porositur një kullë në formën e kokës së Skënderbeut pranë Hotel Tiranës", shënonte dje Aleanca në

Winy Maas tregon bisedat me Ramën, "ironia e BE-së. Britania po del, Shqipëria po hyn"

një videon e Maas që po bëhet virale.

Por çfarë thotë ai konkretisht? Ndiqeni më poshtë.

DEKLARATAT E ARKITEKTIT PRA STUDENTËVE

E mbyll prezantimin me Shqipërinë. Pse? Sepse Shqipëria është për të qeshur. Para disa vitesh mund të vija vërdallë vetëm me makina policie. E njoh Edin nga Parisi kur ai ishte ende një piktor. Ai u bë fillimisht ministër Kulture, pastaj kryetar bashkie dhe tani është kryeministër. Ai bëri disa gjëra të bukura në mes të kaosit dhe e bëri vendin më të bukur. Rregulloi rrëmujën në disa vende. Rregulloi sistemin e ujit dhe bëri disa sheshe. Ishte Barcelona e aplikuar diku tjetër. Një vend ku pihet kafe dhe asgjë tjetër. Shumica e njerëzve aty jetojnë në ShBA. Si mund ta kthejmë parën nga

SHBA? Është një histori suksese me rritje 8% (gënjën-shën.i Aleancës) një mini-Kinë. Po në një mënyrë demokratike (gënjën).

Atëherë më lejoni t'ju tregoj disa nga projektet. Projektet për të kthyer zona të prapambetur anë zona normale.

Në Tiranë kishin një kullë dhe Edi më tha: a mund ta pikturosh këtë kullë?

Unë i thashë, ju keni flamurin më seksi në botë. Mund të propozojmë shumë diçka me të.

Pastaj ai më tha, a mund ta bëjmë qendër tregtare. Ky është vendi, një trekëndësh. Patil një konkurs (Mbasi Edi i kishte thënë të projektonte qendrën-shën.i Aleancës). Pastaj na thanë që ishte projekt shumë i shtrenjtë.

Pastaj ndryshuan projektin dhe na thanë që këtë mund ta bënin. Pastaj, pas shumë vitesh qetësi projekti filloi me një firmë tjetër,



Foto nga projektet e diskutuara

Atelier 4. Çfarë po ndodh. Ata e morën përsipër dhe u ndërtua në këtë mënyrë.

Ok, mbaroi po më pas?

Këtu, ishte një park shumë i bukur. Për ta pastruar liqenin kishin nevojë për densifikim (pra kishin nevojë për ndërtime për ta pastruar?- shën.i Aleancës)

Dhe unë ju thashë, të ndërtojme një lagje, por jo të mërziatshme si lagjet sovjetike. Por çfarë mund të bënim? Qiraja është e ulët, nuk të lejon ndërtime të veçanta. Unë fillova të mendoja si mund ta bënim më të veçantë. Lëvizja disa kulla, rrezova ca të tjera. Ai nuk ishte i bindur. Kjo duket si pas një tërmeti më tha kryetari i bashkisë. Dhe kjo që shihni ju, ishte Rocks of Tirana.

Po më pas?

Kemi një problem me monumentet më tha. A mund të bësh diçka?

Ky është një monument italu- anë që po shkatërrohet. Ne i propozuam një projekt që ruante godinën dhe ndërtonte poshtë saj. (Ky projekt nuk u zbatua kurrë. Rama akoma po përpiqet ta shkatërojë ish-ambasadën jugosllave).

Pastaj më tha, a mund të bëjmë diçka me krenarinë e Shqipërisë? Ne e quajmë Albi dhe ndodhet në këtë vendin këtu. Kjo është toka, përballë një nga xhamive më të mëdha të Europës.

Kjo është kulla jonë e kemi kthyer me fytyrë nga monumenti i Skënderbeut.

E premë dhe i nxorëm ballkonet.

Çfarë është kjo, na pyeti.

Harta e Shqipërisë, ju përgjigjëm.


Patëm një diskutim me politikanë evropianë. A është ky nacionalizëm? Shqipërisë i duhet për të treguar se është seksi.


Ky është një projekt evropian për mënyrën si është ndërtuar. Dhe në fund u pranua.

Por ishte shtrenjtë, shumë shtrenjtë. Çfarë mund të bënim? Vendosëm të bënim Albi 2.0, shumë më të thjeshtë.

Në vend që ta prisim të tërë, krijuam konturet e hartës. Dhe mund të krijojmë shtëpira të tilla.

Kjo është Shqipëria, duke pirë kafe nëpër ballkone.





Por rritja vazhdon, qyteti zhvillohet. Edë më tha një ditë, dua të bëj diçka me historinë.

Çfarë mund të bënim? Kjo është zona pranë sheshit Skënderbej.

Çfarë mund ti shtonim këtij sheshi?

Ka një seri kullash që po ndërtohen dhe që do ndërtohen përreth Sheshit.

Kishte një përpjekje për të krijuar diçka me Skënderbeun, babain

e kombit.

Dhe papritur fillon e krijohet një fyturë njeriu.

Më pas i erdhi radha piramidës, simbolit të komunizmit.

Mund ta hapim e ta ndryshojmë këtë godinë. Ta bëjmë një piramidë të jetuar.

Kjo është Tirana, por Shqipëria është më e madhe se kaq. Doja ta përdorja këtë mundësi për të bërë diçka me bregun.

Pastaj ndryshuam projektin, dhe na thanë që këtë mund ta bënim.

Dhe unë i thashë, ju keni flamurin më seksi në botë. Mund të provojmë diçka me të.

Ky është një monument italian, që po shkatërrohet.

Këtu investitori ynë nga Rusia donte diçka të tillë (Aleanca shton: Bëhej fjalë për Green Coast, e cila nuk njihet si investim rus publikisht)

Ne propozuam diçka që "ngre" natyrën dhe investitori rus na pyeti, ku është resorti im?

Ky ishte qëllimi, diçka në paqe me natyrën. Është diçka si në një film të James Bond. Dhe rusi e pranoi, rusi pranoi një fshat si të James Bond.

Ky është resorti i radhës, sipër një kanyonit. Ky është një projekt që duket sikur thotë "Jam Shqipëria, jam këtu".

Ky është plani dhe ne kemi filluar të punojmë për të.

Kjo është ironia e BE-së. Britania po del, Shqipëria po hyn.

SHKURTE

Nga Pleqtë e Krujës, te fyejt e Gramshit në Berat

Qyteti i një mbi një dritareve, jep 1001 arsye për të qënë aty. Turizmi kulturor ka një rëndësi madhore në zhvillimin ekonomik të Beratit. Prani objektesh, të cilat i përkasin kulturave shumë të ndryshme që kanë ndikuar në historinë e qytetit, nga lashtësia, tek Mesjeta Bizantine, te komplekset otomane dhe deri te rrënojat e lëna pas nga koha e komunizmit. Berati ruan gjurmët e kulturave dhe religjoneve të ndryshme, objektet e të cilave gjenden fare pranë njëra-tjetrës, nga islama helvetizmi te kristianizmi apo te legjenda se aty është varrosur një profet hebre. Të gjitha këto, ja vendosën emrin MultiKulturor; festivalit që po bëhet traditë. Berati i larmishëm, për një audiençë po aq të larmishme sa edhe synon, turistë nga të gjitha anët e botës. "Festivali MultiKulturor Berat" vazhdon rrugëtimin në datat 19/20/21 korrik 2018 në Edicionin e tij të V, me arte pamore, trashëgimi kulturore dhe muzikë nga tabani folkloristik shqiptar.

Një nga pasuritë kryesore të Shqipërisë, është pikërisht folklori muzikor: Gjurmët e lashtësisë së muzikës folklorike shqiptare janë provuar që prej shekujve XIV-XIII p.e.s. Në objekte të ndryshme arkeologjike - skulpture, basoreliefe, terrakota, etj. - janë përfiguruar qartë vegla popullore, që përdoren deri në ditët tona, valltarë, këngëtarë, kostume karakteristike, etj. Një pjesë të kësaj pasurie, prej të dyja anëve të Shkumbinit, do të presë Berati shumë shpej në datat 19, 20 dhe 21 korrik, një improvizim që të çon thellë në histori, për të njohur

dasmën e rrallë shqiptare, për ta përmbyllur në një mbrëmje atmosferike, në tingujt e muzikës së Shtat Dedës. Gjithçka fillon me komunikimin për shtyp të Festivali MultiKulturor Berat në mjediset e Muzeut Etnografik, që përkon edhe me anuncimin për marrjen e Presidencës së Këshillit të Bashkimit Evropian nga shteti Austriak, me praninë e kreut të misionit diplomatik të Austrisë në Shqipëri, si bashkudhëtarë të Festivalit MultiKulturor Berat. Vijohet me një performancë artistike nga një bend muzikantesh austriake. Në orën 21:00 nga mjedisi i Muzeut Etnografik, bëhet përcjellja e nuses beratase për ta pritur krushqit e sazet prej metare, në një inskenim me muzikë dhe rituale prej dasme shqiptare, për të vazhduar në shesh me Pleqtë e Krujës dhe Asamblin Popullor të Beratit. Tri ditë e kryesisht net, me axhendë të ngjeshur artistike, presin të pranishmit, vendas, vizitorë të Festivalit, turistë e të ftuar special. Mbrëmja e dytë kushtuar mërgimit, vjen emocionuese nga grupi i Himarës dhe nga ai i Gjirokastrës; për të vazhduar me grupin e Pjerit në përmbyllje të mbrëmjes. Në përmbyllje të këtij edicioni vjen më datë 21 korrik, nata e "atdheut" me muzikën baritore të Fyejtë të Gramshit dhe iso polifonike nga grupi i Gjirokastrës. Në një mbrëmje atmosferike në oborrin e Teqesë Helvetive, nën tingujt e muzikës së përzgjedhur të Shtat Dedës, ky edicion i V-të, do të mbyllë harmonikisht siparin e aktivitetëve, për të rinovuar takimin me publikun për vitin e ardhshëm.

FILMI

"Fighting for Love" dhe historia e Havzi Nelës

"Fighting for Love" është titulli i filmit të ri shqiptaro-amerikan që ka nisur xhirimet. Filmi është prodhim i kompanisë filmike Fati Film Production në New York. Xhirimet e filmit tashmë kanë startuar në Amerikë për të vijuar në Shqipëri me aktorët kryesorë si: mjeshtri ndërkom-bëtar Fatmir Bardhoci, Mjeshtri i tij, Korean Jugori: Ko Eui Min, mjeshtri më i madh në botë, 6 herë pjesëmarrësi në lojërat olimpike Shaban Sejdin, 14 herë kampioni i botës në Kick Thai box, Azem Maksutaj. Aktorë të mirënjohur në skenat botërore të filmave action, Japonezi Akhiro Haga me ekipin e tij STUNT team, Aktorët STUNT Jakup Muja, Sam Youl dhe Mehedin Selimi, të cilët do të vijnë në Shqipëri enkas për të xhiruar pjesë nga filmi. Nuk do të mungojnë aktorët e ekranit shqiptar si: Bruno Shllaku, Besmir Bitraku, Mimoza Marjanaku, Freskida Miloti. Filmi "Fighting for Love" tematikë kryesore ka ngritjen e imazhit të shqiptarëve në botë, evidën-

timin e trashigimisë kulturore të pellazgëve në artet luftarakë si dhe bashkëjetesën fetare, si fenomen i rrallë i jetuar vetëm nga shqiptarët. Filmi "Fighting for Love" flet për historinë e jetës së një të riu nga një qytet verilindorë i Shqipërisë siç është Kukësi.

Personazh kryesor është Iliri, një 15 vjeçar i motivuar nga filmat aksion të Van Dame, i traumatizuar nga varja e poetit të cilën e pa me sy në vitin 1988, vendos të ikë i vetëm nga Shqipëria pikërisht ditën kur gjyshi i tij vdes. Arrin të largohet nga Kosova në Gjermani ku edhe njihet për herë të parë me artet marcialë. Ëndërra e tij ishte të shkelte në tokën e endrurve, Amerikën. Këtë ëndërr e bën realitet vetëm mbas 30 vite përpjekjesh e pune. Njihet me një femër me prejardhje shqiptare e cila, luan një rol të dyfishtë. Në njerën anë e dashura e bosit të mafias e detyruar, e droguar në anën tjetër e dashuruar me personazhin, i cili rrezikon jetën e tij për të shpëruar atë nga kthetrat e mafias.

I JEPET LAMTUMIRA FADIL HASËS

Mes dhimbjes dhe lotëve iu dha dje lamtumira e fundit aktorit të madh të humorit, Fadil Hasa. Homazhet u zhvilluan në Teatrin "Aleksandër Moisiu" të Durrësit, ku morën pjesë familjarë, të aferm, miq dhe kolegë të aktorit të njohur durrsak. "Artistë si Fadil Hasa janë mrekulli popullore. Ai bëri që ky popull të qeshte në vitet më të vështira", deklaroi Zef Deda. Artisti i Popullit, Gjergj Vlashi dhe Haxhi Rama qenë dy regjisorët me të cilët Fadil Hasa bashkëpunoi gjatë pranë estradës profesioniste të qytetit të Durrësit. "Ne kemi humbur një pjesë të jetës sonë, një pjesë të vetes sonë", u shpreh Vlashi. Ndërsa Haxhi Rama e cilësoi



Fadil Hasën si një nga "humoristët më të mirë shqiptarë", që ka "nderuar vendin dhe qytetin e tij". Ikona e humorit u nda nga jeta të hënën në moshën 78-vjeçare pas një sëmundjeje të rëndë. Mes të pranishmëve ishin edhe kryetari i PD, Lulzim Basha, ish-kryeministri

Sali Berisha si dhe kryebashkiaku i Durrësit, Vangjush Dako. Basha vendosi një kurorë me lule në hollin e Pallatit të Kulturës në Durrës, ku u organizuan homazhet për nder të artistit të madh, Fadil Hasa. "Sot është një ditë e trishtuar për artin shqiptar, personalisht për mua si një admirues i Fadil Hasës që i vogël. Një nga njerëzit e pakët që në Shqipërimë e ditëve të errëta, dinte të sillte buzëqeshje dhe humor në shpirtat dhe në shtëpitë e shqiptarëve", ishte mesazhi i Bashës pas homazheve.

Aktori i madh i humorit, Fadil Hasa, u nda nga jeta një ditë më parë në moshën 78-vjeçare, pasi prej një kohe të gjatë vuante nga një sëmundje e rëndë në mushkëri

Opinion i Ditës

Samit pa frymën e Helsinkit

Dr. Jorgji KOTE

(Vijon nga faqja 1)

... verë kur Evropën e ka mbytur zhegu i paparë i meskorrikut.

Gjithçka në prag të këtij samiti ishte e nxehtë, përvëluese. Këtë klimë dhe atmosferë jo vetëm nuk e «ftohën» dot por e ndezën dhe më tepër deklaratat e tij qortuese ndaj aleatëve në Samitin e NATO-s në Bruksel sidomos me «2 apo 4 për qindëshin» e famshëm, denoncimin ndaj Gjermanisë së Merkel si «rrob» i Rusisë, vendosja e tarifave mbi importet evropiane të celive, aluminit, aludimet mbi BE-në «si armik» në fusha të caktuara si tregtia, etj. Ndërsa në Londër Trump nuk u soll politikisht si Zotëri me dy deklarime kundërtë në ndaj Theresa May, Kryeministres së Britanisë, kësaj aleate tradicionale. Dhe së fundi, Trump i paketoj këto «dhuratat» për Putinin me pohimin se takimi me të ishte më i lehti krahasuar me takimet dhe forumet e tjera.

Tensioni politik ruso-amerikan u rrit ndjeshëm kur Ministria amerikane e Drejtësisë njoftoi në prag të Samitit ngritjen e padisë ndaj 13 agjentëve sekretë rusë për ndërhyrje në fushatën zgjedhore presidenciale amerikane të vitit 2016.

Jo më pak të nxehta ishin axhenda dhe temat e samitit plot sfida madhore për të dyja vendet dhe bashkësinë ndërkombëtare. Vërtet që krahas të tjerash zotërojnë 92 për qind të arsenalit bërthamor botëror, por ndryshe nga tri dekada më parë, tani roli dhe fuqia e SHBA dhe Rusisë po ballafaqohet me demarshet e vendeve/grupimeve të tjera të mëdha, në kërkim të krijimit të një bote multipolare në planin politik, ekonomik dhe atë ushtarak.

Rusia, duke përfutur nga krisjet dhe të çarat mes aleatëve Perëndimorë ka shtuar pretendimet dhe presionin për t'u bërë fuqi e madhe botërore, ashtu sikurse dhe Kina dhe Japonia. Në «dëshminë» politik arab, dihet se Rusia përkrah Iranin, kurse SHBA anon nga Arabia Saudite; ajo prishi në mënyrë të njëanshme Marrëveshjen gjashtëpaleshe të Atomit; ndërsa Rusia bëri një lëvizje të fuqishëm politik-ushtarak me ndërhyrjen e saj në mbështetje të presidentit sirian Assad duke foruar ndjeshëm pozitën e saj atje.

E megjithatë, nuk mjafton thjesht dhe vetëm freskia dhe reputacioni i Helsinkit si kryeqytet për trajtimin dhe ca më pak zgjidhjen e këtyre problemeve që është pak t'i quash «patate të nxehta». Në radhë të parë, sidomos nga pala amerikane pritej me shumë interes pasqyrimi i «frymës së Helsinkit». Nuk dihet nëse ia kanë thënë këshilltarët Trumpit se më 1 gusht 1975, në «Palais Finlandia», pranë vendit ku Trump takoi Putinin, paraardhësit e tyre, Ford dhe Brezhnev s'ishte bashku me 33 liderë të tjerë nga Lindja dhe Perëndimi nënshkruan Aktin Final të Helsinkit «e bibla politike e



demokracisë së sotme liberale; me tre «shporta» - demokracia, krijimi i besimit/siguria dhe të drejtat e njeriut të zbërthyer në 10 parime ose «Dekalogun e Helsinkit». Këto të fundit shërbyen si pikë madhore referimi për shembjen e komunizmit dhe fitoren e demokracisë në Evropën Qendrore dhe Lindore. Madje, OSBE-ja, produkt i Helsinkit është dhe për vetë Rusinë, pas OKB-së, organizata më e preferuar ndërkombëtare. Mirëpo «fryma» e Aktit Final të Helsinkit nuk u ndje në këtë Samit dhe kjo jo rastësisht; por, sepse Rusia ka vite që shpërfill hapur disa nga elementët e Dekalogut të Helsinkit; më konkretisht, demokracinë liberale, të drejtat e njeriut, mosndryshimin me forcë të kufijve, etj. Gjithashtu, aneksimi i Krimesë, pushtimi i Ukrainës Lindore, dhunimi i të drejtave të opozitës dhe shoqërisë civile, ndërhyrjet në punët e brendshme të vendeve të tjera dhe vetë SHBA-në, janë disa prej shembujve më «ulëritës» të këtij fakti.

Natyrisht nuk mund t'i kërkohej Presidentit Trump që të tregojë jo i sjellshëm, as të tregojë mistrec e të shkakonte grindje të kota apo të refuzonte vullnetin pozitiv për bashkëpunimin dhe afrim me Rusinë, për vetë rolin e saj të madh ndërkombëtar dhe mundësitë e shumta që ofron në të gjitha planet e pa kurrfarë paragjykimi. Por, si zakonisht në të tilla raste, siç kanë vepruar dhe paraardhës të tij në kohëra më të vështira, fare mirë Trump mund të kishte shprehur solemnisht përpara shtypit mbështetjen amerikane ndaj vlerave dhe parimeve universale, lirinë dhe

demokracinë, bashkëpunimin me komunitetin ndërkombëtar, OKB-në, OSBE-në, etj. Edhe pohimi i tij që «më mirë të sakrifikojmë politiken për paqen se anasjelltas» nuk mjafton i pasqyruar me komponentët të tjerë të Helsinkit.

Gjithashtu, ai mund fare mirë të shprehte hapur mospajtimin me Krimenë, Ukrainën dhe rastet e tjera, si bazë për një të ardhme më të mirë. Po ashtu, prej tij pritej një referim shumë më simetrik ndërmjet Rusisë dhe aleatëve strategjikë perëndimorë.

Trump bëri thirrje të mos merrni me të kaluarën, por të shohim përpara; por, pa sqaruar cilën të kaluar të lemë pas dhe për cilën të ardhme bëhet fjalë në kuptimin politik dhe demokratik. Mundet që Presidentit Trump ka dashur t'i japë një paradhënie politike «konkurrentit të tij të mirë» Putin, me qëllim që t'i marrë më shumë nesër, siç ka vepruar me sukses në negociatën dhe ujdin tregtar. Këtë do të tregojë koha, por faktet e lartpërmendura nuk të bëjnë shumë optimist në këtë drejtim, sidomos përballë një Putini me aq përvojë lidhësi. Gjithsesi nuk ka dhe shumë arsye për nxitim e panik, sikur do të bëhet kiameti, sepse ndryshe nga Rusia, SHBA shquhet për traditën shekullore në fushën e demokracisë dhe patur të gjitha komponentët e nevojshëm e mbi të gjitha «check and balance».

Padyshim që mungesat, dëshimet, vendimet, polemikat dhe grindjet që kanë manifestuar BE dhe SHBA-ja gjatë kësaj periudhe i kanë dhënë shumë «municion» politik dhe luftarak Rusisë në demarshet e saj të vazhdueshme poli-

tike, diplomatike dhe ushtarake, përfshirë dhe Ballkanin Perëndimor. Ndryshe nga SHBA që po anon nga forca ose «hard power» Rusia pa hequr dorë nga modernizimi ushtarak, po intensifikon dhe «pushtetin e butë» brenda dhe jashtë vendit sidomos me art, kulturë, muzikë dhe sport. Botërori i Futbollit 2018 me atmosferën e krijuar ishte shembulli më i freskët planetar i këtij sukcesi. Ndaj Putin i dhuroi bashkëbiseduesit një top futbollit sikur t'i thoshte se «tani topi është në fushën tënde».

Ndërkohë, SHBA, perëndimi në përgjithësi dhe Rusia kanë dhe shumë interesa dhe nevoja të përbashkëta që i afrojnë në luftën kundër terrorizmit, kufizimit dhe çarmatimit bërthamor, shtyrjes së Marrëveshjes mbi Çarmatimin Bërthamor «New Start», pasojave nga ndryshimet klimatike, luftën ndaj krimit dhe korrupsionit, bashkëpunimi shumëpalësh, etj.

Ndaj, ky takim nuk mund të krahasohet kurrsesi me samitet e Luftës së Ftohtë ose të fillimit të viteve 90. Tani bëhet fjalë për dy vende demokratike me gjithë diferencat ndërmjet tyre dhe problemet me të cilat ndeshet Rusia në kuadrin e «demokracisë së menazhuar» Por, dhe demokracia perëndimore, me gjithë shkëlqimin dhe traditat e saj të njohura po tregon shenja dobësie dhe lëndëndeje që po shfrytëzohen nga forcat populiste dhe ekstremiste.

Me siguri që në këtë Samit me aq sa e lejonte vendi është diskutuar dhe mbi gjendjen/alternativat në rajonin e Ballkanit Perëndimor, për të cilin krahas SHBA-së po investohet ndjeshëm edhe Rusia. Këtu padyshim ka vendin e vet

edhe gështja e Kosovës. Krahas BE-së në pozita gjithësesi më të dobësuar për shkaqe të njohura, po shtohen zërat për përfshirjen atje krahas SHBA-ve dhe të Rusisë. Gjithsesi, kjo e fundit ka një pengesë të madhe besueshmërie në këtë drejtim për shkak të aneksimit të Krimesë dhe Ukrainës Lindore dhe krahasimit të tyre me Kosovën; kur në fakt Kosova mbetet rast krejtësisht i veçantë dhe nuk mund të shërbejë si precedent, siç pretendon diplomacia ruse.

Megjithatë, këto aspekte pritet të jenë objekt i bisedimeve më konkrete e të mëvonshme sipas çështjeve përkatëse, sepse ky Samit ishte sikurse pohuan Trump dhe Putin vetëm fillimi i një procesi të ri cilësor.

Së fundi, mbizotëron mendimi se «fituesi» i këtij Samiti është Putini; sepse takimi me Trump e shkëputi atë zyrtarisht nga izolimi ndërkombëtar; i forcoi imazhin publik dhe mbi të gjitha ndihmon për ta vendosur Rusinë gati-gati në pozita të barabarta me SHBA-në. Mirëpo kjo përbën një «as» fortë për Putinin në demarshet e tij të ardhshme diplomatike me pjesën tjetër të botës. Në fakt, ai u «hodh menjëherë në sulm» duke fajësuar Perëndimin të «Fox News» për ngjarjet në Ukrainë, Krime dhe për konfliktin në ish-Jugosllavi, etj. Ndërkohë, u mjaftua duke shprehur gatishmërinë për bashkëpunim ushtarak për Sirinë, por me Assadin dhe për Iranin, dhe ftoi ekspertët amerikanë të bashkëpunojnë me ata rusë lidhur me pretendimet për ndërhyrjet në zgjedhjet amerikane; aq sa Trump e cilësoi atë si «ofertë pabesueshmërisht të mirë» duke sfiduar zhgënjyjer shërbimit e specializuar amerikane.

Por dhe për Presidentin Trump, edhe pse pas kthimit në Washington po ballafaqohet me një «valë tjetër të nxehtë» kritikash dhe denoncimesh dhe nga kampi i vet politik, ky Samit ishte një show mediatik, sidomos për zgjedhësit e tij, votën e të cilëve ai e kërkon në zgjedhjet për kongresin në nëntor dhe pak më vonë për një mandat të dytë presidencial.

Edhe pse nuk dihet ende më shumë mbi përmbajtjen dhe rezultatat konkrete të bisedimeve ndërmjet tyre, parë nga ky këndvështrim dhe si takimi i parë dy-palësh i presidentit rus dhe amerikan nga viti 2010, sidomos pas ardhjes së Presidentit Trump me logon «Amerika e para» që ka tronditur rendin botëror shumëpalësh të krijuar nga SHBA mbi shtatë dekada më parë, ky Samit ishte pozitiv, historik dhe i mirëpritur nga të gjithë.

Vetëkuptohet se aleatët tradicionalë të SHBA-ve, sidomos BE-ja, NATO e të tjera po i ndjekin me interes e jo pa shqetësim këto zhvillime intriguese. Ata po konfirmojnë vullnetin dhe vendosmërinë për të vijuar bashkëpunimin tradicional me SHBA-të, si miq dhe aleatë të

Opinioni *i* Ditës

Punësimi i kumarit

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... t'i vendosur paratë e tyre në skemat piramidale të kompanive si "Sudja", "Populli", "Vefa", "Gjallica" etj., nga një studim i një instituti joqeveritar, shifra e përafërt (dalë nga anketa të institutit) shkon në 13 mijë vetë. Pra, rezultuan 13 mijë kryefamiljarë, "të punësuar" nën ethet e Eldorados së fajdeve shqiptare për të shkatërruar familjet e tyre! Sot, 22 vite më vonë, kemi ethet e basteve, kemi bastomaninë! "E ç'të keqe ka të vësh një bast sportiv?", mund të pyesë shumëkush. Asnjë të keqe. Por, jo kur kthehet në qëllim jete. Jo kur arrin aty etheja, sa roja i fabrikës të vërë në bast gjithë rrogën e muajt dhe në kushte depresioni, të hidhet nga maja e oxhakut të saj, duke i dhënë fund jetës! Shumica e atyre familjeve që kishin vënë "bast" shtëpitë e tyre në ethet piramidale të viteve 1995-1996, nuk i pa më paratë e shtëpive të tyre të ktheshin. Sot, pikat e basteve dhe qendrat e lojërave të fatit janë shtuar tri herë brenda 24 muajve! Duke shkatërruar mijëra ëndrra të pastra për sukses në jetë, duke thithur energjinë dhe shpresat jo vetëm të të rinjve tanë që mbledhen aty si mizat rreth kalit të ngordhur, por edhe mesoburra e të moshuar! Krahas rekordit botëror në numrin e bar-kafeneve, duke ia kaluar edhe Spanjës (654 bar-kafene për 100 mijë banorë), kemi thyer edhe rekordin e pikave të basteve për 100 mijë banorë! Na e kalojnë për numrin e lojërave të fatit në një sipërfaqe mbi 1000 ha vetëm Monte Karlo dhe Las Vegas. Për fatin e keq të të gjithëve ne, në 12 kompanitë më të mëdha private në Shqipëri, që kanë më shumë se 1000 punëtorë, tri janë kompani të lojërave të fatit. Fitimi i deklaruar, jo ai informal, në një vit si 2017-a, pa ngjarje të mëdha sportive si, për shembull, Kupa e Botës në futboll, arriti në 18 milionë euro në vit. Duke pasur parasysh evazionin e lartë të sektorit, fitimi duhet të ketë qenë rreth 4 herë më shumë, pra aty tek 70-75 milionë euro. Për këtë vit, me ethet e "Botërorit 2018" në Rusi që sapo i kaluam, fitimi parashikohet mbi 120 milionë euro! Kjo është ekonomia jonë parazitare, përtaçe dhe primitive, ku njerëzit nuk punojnë, por... luajnë. Vënë baste nëpër loto, diskutojnë gjithë ditën për shanset e fitores, mes një gote raki, dy krriklave birë apo 5 qofteve. Në vend që paratë e shqiptarëve të kanalizohen në sektorë prodhues e premtes për shërbimet, si turizmi, agro-turizmi, produktet bujqësore për eksport etj., shumica shkojnë në të 6700 pikat e lojërave të fatit, të përhapura në të gjithë trupin e vendit, si çibanë të shëmtuar. Këto pika thithin edhe shpresën e fundit për energji pozitive dhe nisima biznesi, ku protagonistë të jenë të rinjtë. Në të kundërt: këta mësohen të fitojnë para duke... hedhur zare! Zarin elektronik të kryeqe tek skedina e lotos, të bastit sportiv



apo të ruletës. Dhe të gjithë e dinë se ku kanë përfunduar kumarxhinjtë e sëmurë (me pasion të pakontrolluar), por asnjë nuk ndalet, nuk frikësohet "ç'po i bëj vetes". Madje, këtë lloj kumari e nxisin reklamën në televizione private dhe edhe në atë publik. Ky është shkallmimi i moralit të të bërit shtet, apo të formatimit të një ekonomie të shëndoshë. Nuk na mjafton ajsbergu i tmerrshëm

i 600 milionë eurove të kanabisit dhe tregut të kokainës që përpiqet të depërtojë nëpër dërrasat e çara të ekonomisë sonë formale. Tani na duhen edhe këto 120 milionë euro kumar. Dhe qeveria rri e vështron. Madje edhe më keq. Një propozim absurd mund të shkojë deri në Komisionin e Ekonomisë në Kuvend, duke kërkuar që për lojërat e fatit, tatimi mbi xhiron të llogaritet pasi të jenë zbritur shpenzimet opera-

Sot, pikat e basteve dhe qendrat e lojërave të fatit janë shtuar tri herë brenda 24 muajve! Duke shkatërruar mijëra ëndrra të pastra për sukses në jetë, duke thithur energjinë dhe shpresat jo vetëm të të rinjve tanë që mbledhen aty si mizat rreth kalit të ngordhur, por edhe mesoburra e të moshuar! Krahas rekordit botëror në numrin e bar-kafeneve, duke ia kaluar edhe Spanjës (654 bar-kafene për 100 mijë banorë), kemi thyer edhe rekordin e pikave të basteve për 100 mijë banorë! Na e kalojnë për numrin e lojërave të fatit në një sipërfaqe mbi 1000 ha vetëm Monte Karlo dhe Las Vegas.

tive dhe fitimi i ditës nga klientët që luajnë. Kësaj i thonë: bie shi mbi tokë të stërlagur! Biznesi i lojërave të fatit renditet ndër sektorët me normën më të lartë të fitimit që shkon edhe në 80% të xhiros. Është ndoshta i fundit i sektorëve që mund të ketë nevojë për ndihmë nga politikat fiskale të qeverisë. E megjithatë, qeveria duket se nuk ka ndër mend të kursehet për të. Cili grup lobimi ia ka marrë mendjen Ministrisë sonë të Financave dhe Ekonomisë kësaj radhe? Nëse ky projekt do të kthehet në ligj, atëherë do të kemi rastin më të shëmtuar të shndërrimit të përpjekjeve për një ekonomi reale të qytetarëve, me forca të përqendruara në sektorët tanë prodhues, në një ekonomi që punëson me lojëra fati, me dyqane, butikë, restorante, motele e hotele të përfutuara nga para të dyshimta. Sistemi bankar prej disa vitesh tashmë nuk po e shton numrin e punonjësve. E njëjta dukuri vërehet dhe me punësimin në kompanitë e telekomunikacioneve. A mos duhet të varim shpresat tek punësimi nga kumari dhe të themi: Të na rrojnë bastet që shpëllajnë një pjesë të parave të pista dhe qethin rrogat tona!

HOROSKOPI

DASHI

Mos u shqetësoni për shëndetin tuaj më shumë seç duhet, sepse kjo do e përkeqësojë gjendjen tuaj. Do t'ju jepjen mundësi të reja për të fituar para. Kaloni më shumë kohë pranë njerëzve që iu duan dhe kujdesen për ju. Mund të bini në dashuri me shikim të parë.

DEMI

Është koha e duhur të ndaloni cigaren, përndryshe do ta keni shumë të vështirë ta bëni një gjë të tillë më vonë. Do të shpenzoni më shumë se buxheti juaj. Mos i nënvlerësoni në asnjë mënyrë përgjegjësitë në shtëpi. Sa i përket anës romantike, është dita juaj sot.

BINJAKET

Krijoni një imazh të bukur në mendjen tuaj, në mënyrë që të ndiheni sa më mirë. Do të realizoni disa plane shumë të rëndësishme, të cilat do t'ju sjellin fitim parash. Është një ditë e mirë për të komunikuar me njerëzit që takoni rrallë. Sot do të jetë një ditë shumë e bukur për ju në çift.

GAFORJA

Duhet të praktikoni meditimin dhe jogën. Do të keni burime të reja të të ardhurave. Nuk është momenti i duhur që të ndani ndjenjat apo sekretet me të afërmit tuaj. Sot do të vlerësoheni për meritat tuaja në punë. Mos ndaloni tekssa jeni duke i dhënë maknës. Sa i përket marrëdhënies në çift, kjo nuk do të jetë dita juaj me fat.

LUANI

Nervoziteti mund t'ju dobësojë dhe të ndikojë negativisht në mendimet tuaja. Inkurajojeni veten duke menduar pozitivisht. Lodhja në punë do të sjellë rezultat. Fëmijët do t'ju shqetësojnë paksa pasi kaloni në shumë kohë me aktivitetet të ndryshme sesa të mendojnë për karrierën e tyre.

VIRGJERESHA

Duhet të relaksoheni dhe të përfshihen në aktivitete që ju japin kënaqësi. Mund ta gjeni veten në një situatë interesante. Do të kaloni një ditë shumë interesante me miqtë tuaj. Sa i përket marrëdhënies në çift, nuk do të jetë dita juaj me fat. Mendoni për mënyra të reja sesi të bëni para.

PESHORJA

Bëni kujdes me shëndetin tuaj, mënyra sesi do t'i trajtoni fëmijët, do t'i mërzisë ata. Duhet të frenoni veten, pasi vetëm do të krijoni barrierë. Do të jeni të mbushur plot me nderja dashurie, vetëm se përpiqni të kuptoni se çfarë po ndodh rreth jush, keni aftësinë të arrihi shumë në jetë, kështu që mos humbisi mundësitë që iu dalin përpara.

AKREPI

Mbani dietën nën kontroll dhe bëni ushtri-m fizike për të qenë në formë. Do të keni dëshirë të udhëtoni dhe të shpenzoni para, por mos e teproni. Nëse do të përqendrohni në punë, do t'ju ndjekë vetëm sukses. Bëni kujdes në marrëdhënien në çift.

SHIGJETARI

Do të shroheni pas një sëmundje afatgjatë. Evitoni një person egoist, pasi mund t'ju injektojnë. Miqtë dhe familjarët tuaj do t'ju sillen. Sa i përket romancave, disa festa do të jenë emocionuese por edhe të lodhshme. Bëni kujdes me veprimet dhe fjalët tuaja.

BRICJAPI

Frika psikologjike mund t'ju dëmtojë. Përqendrohuni në mendime pozitive. Investimet duhet të bëhen me një perspektivë afatgjatë. Marrëdhënia me bashkëshortin/en mund të tensionohet për shkak të ndërhyrjes së padëshiruar të të huajve. Gjithashtu bashkëshorti mund t'ju shkaktojë disa humbje soti.

UJORI

Është koha të relaksoheni, të largoni stresin dhe të bëni joga. Rritja e financave do t'ju bëjë të bëni disa blerje të rëndësishme, por do të shqetësoni të afërmit nëse e teproni dhe shpenzoni për gjëra të panevojshme. Zgjidhni fjalët me kujdes kur flisni me njerëz të rëndësishëm.

PESHQIT

Kujdesuni për shëndetin. Përmirësimi i financave është i sigurt. Disa ndryshime në shtëpi mund të çojnë në probleme me të afërmit tuaj. Sa i përket dashurisë do të jetë një ditë e mahnitshme. Veprimet e bashkëshortit/ës do ta bëjnë ditën tuaj të mrekullueshme. Edhe në punë gjërat duket se janë në favorin tuaj.



Kukësi mposht maltezët me dy barazime, kualifikohet në turin e dytë eliminator të Championsit

Kukësi ka siguruar kualifikimin në fazën e dytë eliminator të "Champions League" pasi dje ka barazuar me rezultatin 1-1 ndaj Valletas në transfertë. Skuadra e drejtuar nga Cungu pas një pjesë të parë të dobët, në fraksionin e dytë të lojës e pa veten në disa-

vantazh. Ekzaktësisht në minutën e 67-t Piciollo zhblokoj për skuadrën malteze. Kur dukej se Kukësi ishte farë pranë eliminimit, pak minuta nga fundi, në të 84-n, Dzaria shënoi golin e barazimit që i dhuroi Kukësit kalimin në fazën tjetër.

Kujtojmë që takimi i parë i luajtur javën e kaluar në "Loro Boriçi" përfundoi me rezultatin e bardhë 0-0. Në raundin tjetër Kukësi do të luajë me fituesin e çiftit NK Olimpija Ljubljana-Qarabag. Në ndeshjen e parë skuadra azere ku luan shqiptari Ansi Agolli ka fituar minimalisht 0-1.

Manovrat madrilene



Real Madridi ka në dorë Kurtuan, ëndërron Hazardin

Tibo Kurtua është gjithnjë e më pranë portës së Real Madridit. Sipas gazetës spanjolle "Marca", në orët e ardhshme "Los blancos" mund të zyrtarizojnë akordin me Çelsin për një total prej 35 milionë eurosh të derdhura në arkat e klubit londinez për shërbimeet e 26-vjeçarit belg. Real Madrid ka qenë gjithnjë në ndjekje të David De Geas, por Mançester Junajtidi nuk ka ndër mend të lërë të lirë spanjollin, ndaj drejtuesit madrilenë ndër ruan kurs nga gardiani i Belgjikës, që në "Rusi 2018" u shpall dhe portieri më i mirë i tuerut. Por nëse për Kurtuan Çelsi është gati të pranojë ofertën, për Eden Hazard gjërat janë më të komplikuar. Kjo sepse blutë e Londrës kanë shkrepur një shifer të çmendur. Çelsi është gati të lërë të lirë elfin belg, por për këtë duhen jo më pak se 200 milionë euro. Drejtuesit e Realit shohin të Hazard njeriun e duhur që mund të mbushë sadopak boshllëkun e lënë nga largimi i Kristiano Ronaldos.

Pas 10 vjetësh trofeu më prestigjioz individual në futboll mund të ndërrojë pronar

"Topi i Artë", fundi i dominimit Mesi-CR7?

Griezman, Mbape dhe Modriç, kandidatë seriozë

Jeton Selimi

Botërori i Rusisë ka lënë trashëgiminë e tij dhe me shumë gjërave, kanë ndryshuar dhe hierarkitë në rrugën drejt "Topit të Artë" që gjatë dhjetë viteve të fundit është ndarë nga dy lojtarë të vetëm, Kristiano Ronaldo dhe Lionel Mesi. Dhe nëse CR7 ka shanse, këtë vit Mesi është lënë pas nga Grizman, Mbape dhe Modriç. E nisim me Ronaldon që me Portugalinë e la botërorin në 1/8-at e finaleve me një paraqitje jo të mirë në dy ndeshjet e fundit. Por nuk duhet harruar se ka shënruar 4 gola, midis të cilave tregolëshi ndaj Spanjës. Në maj, me fanellën e Realit fitoi Championsin e pestë, e treta radhazi, veprimtarin ku shënoi 15 gola në 13 ndeshje. Ndaj nuk mund të konsiderosh Kristianon si të rënë nga fronti. Mbreti nuk ka ndër mend të abdikojë dhe këtë e konfirmoi me kalimin të Juvja. Kuotat në rritje aktualisht janë ato të Antuan Grizman. "Djallushi" fitoi Europa Ligën me Atletikon e Madridit dhe në botëror ishte lideri i Francës kampione. Por Franca ka edhe një emër tjetër në listë, edhe ai



është Kilian Mbape. Shkatërrues me shpërthimet e tij, i pakapshëm dhe i pamarkueshëm, por nuk ka pasur vijueshmërinë e Grizmanit. Djalooshi-mrekulli i

futbollit botëror ka mahniur kundër Argentinës, ka shënruar kundër Perusë, ka qenë vendimtar në finale duke u ulur përkras madhërisë së tij Pele. Në

luftën për "Topin e Artë" mund të penalizohet nga mungesa e trofeve ndërkombehtarë me klubin e tij. Por "Rusi 2018" ka kurorëzuar përfundimisht edhe

Luka Modriç. Prej vitesh i konsideruar si ndër mesfushorët më të mirë, për të mos thënë më i miri. Ka qenë lider dhe kapiteni i asaj Kroacie që i habititi të gjithë. Në luftën për "Topin e Artë" ka nga ana e tij edhe Ligën e Kampioneve. Si përfundim, përshtypja është se viti 2018 mund të sjellë fundin e dominimit Mesi-CR7, por duhet pasur kujdes, pasi edhe muajt e parë të sezonit të ri janë vendimtarë në përcaktimin e trofeut të rëndësishëm. Ronaldo kërkon të konfirmohet, Mesi ka humbur terren për shkak të dështimit me Argentinën, ndërsa me prepotencë po ecin para kampionët e rinj të botës, Grizman dhe Mbape.

"PLESHTI" NËN AKUZË

Lionel Mesi zhgënjëu lënë Botërorin 2018. Por sulmuesi i Barcelonës nuk u kryqëzua vetëm për paraqitjen personale me vetëm një gol në katër ndeshje. Një nga akuzat që rëndoi mbi "Pleshitin" ishte dhe ndikimi i tij në skuadër. Madje u fol se ishte pikërisht ai që vendoste për formacionin. Këto zëra kanë marrë një konfirmim të fortë nga Nikolas Burdizo. Mbrojtësi argjentinas që luan me Torinon ka zbuluar për mediat argjentinasë se është pikërisht Lionel Mesi ai që e mban larg Kombëtares prej vitesh. Shkak një debat mes tij

Burdizo: Mesi më përjashtoi nga Kombëtarja



dhe sulmuesit. "Ishte ndeshja Argentinë-Kolumbi, e cila u mbyll në barazim 0-0.

Në atë sfidë ai u nervozua shumë për një pasim të gabuar. I kërkova të sqaroheshim dhe në momentin që po afrohej mendova se do të më godiste. Ndërhynë lojtarët e tjerë dhe në fund u sqaruam, por që nga ajo ndeshje unë nuk jam grumbulluar me Kombëtaren edhe pse luaja me Romën në Serinë A", ka thënë Burdizo. Deklaratat e mbrojtësit i kanë hedhur më shumë benzinë zjarrit të polemikave, por edhe akuzave në dëm të Lionel Mesit, i cili zhgënjëu të gjitha pritshmëritë gjatë Botërorit 2018.

Është cilësuar si transferimi i shekullit. Sigurisht, Juventusit është ai që do të ketë shërbimet e një prej lojtarëve më të mirë të historisë së futbollit, por edhe Seria A italiane ka përfitime, madje shumë sa i përket imazhit. Për ta konfirmuar këtë mjafton, të shohësh mediat ndërkombehtarë, ku Kristiano Ronaldo ka pushtuar faqet e para me fotot dhe deklaratat e tij gjatë prezantimit zyrtar me kampionët italianë. Përtej Adriatikut nuk fshihet aspak entuziazmi se me "Topin e Artë", Seria A fiton sërish sharmin që kishte humbur prej vitesh. Po ashtu, shpresat janë të mëdha se me Ronaldon si ekspert, Juventusit tani mund të fitojë Ligën e Ka-

Prezantimi i sulmuesit "pushton" mediat


Ronaldo te Juventus, një çështje botërore



mpioneve. E ndryshme është atmosfera që përçohet në Spanjë sidomos nga mediat madrilene. Ato janë kapur pas deklaratave të portugezit, ku njëra dhemb më shumë se të tjerat. "Nuk mendoj se në Madrid po qajnë për mua", tha Ronaldo,

duke konfirmuar se raportet me klubin ishin ftohur prej kohësh. Nuk mund të mungonte si lajm kryesor prezantimi i CR7 te Juventusit në mediat portugeze, që si gjithmonë nuk kursehen në elozhet ndaj sulmuesit. Në thellë në detaje hyjnë mediat angleze. Këto të fundit e quajnë Kristiano Ronaldon si një "showman", teksa forcojnë bindjen se ai do të kthejë imazhin dhe prestigjin e dikurshëm të kampionatit dhe skuadrave italiane.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Miller e Verdi-t.
5. Më e mira është rektor.
9. Inicialet e Derain.
11. Kishte 100 Teba.
12. Është vija e portës
13. Në fund te rritjes.
14. Drejtori Lokale Përmet.
15. Inicialet e Seagal.
16. King Cole i muzikes.
17. Ishte shpendi simbol i Jezu Krishtit.
21. Artikulli spanjoll.
23. Janë fjalëpakë.
25. Fillojnë titrat.
26. Është i mërzitshmi.
27. Ashtu si jeton heremit.
29. U kompozua nga Ravel.
30. Janë spanjollët dhe portugezët.
32. Një kitarë indiane.

33. Janë edhe ato të sigurimit.
35. Është e harlisur në xhungël.
37. Mbyllin fushatat.
38. Kështu thirrej Eisenhower.
40. Ai dhe ajo.
41. Fillojnë vallen.
42. Inicialet e Delon.
44. Kalohet në gjumë.
45. Martini që që këngëtare
46. Një thirrje me emra.

VERTIKAL

1. U quajt qyteti atomik.
2. Qyteti i Abrahamit.
3. Italia në tabela.
4. Sapo fillojnë.
5. Nemo ai i Nautilus.
6. Janë në botë
7. Një tabu islamike
8. I famshmi Pacino.
10. Janë si falimentime
11. Ngjyhet një në tavolocë.
12. Timo i Mato Grudës.
14. Janë borxhlinj.
17. E përditshmjia që ke në dorë.
18. Carson i fumetti-t.
19. U shkrua nga Sartre.
20. Në fund të vitit.
22. Është lloj poezie.
24. Janë shtëpi... qeni.
25. Janë kapriçiot.
27. Verifikuar pjesërisht.
28. Kërcimi i Fred Astaire.
31. Është sekrete në derë.
34. Kodi i celularit.
36. Daja i Amerikës.
39. Kaluar në krye.
43. Fillojnë detyrën.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

1. Atkinson, alias Mister Bean.
5. Ishte dyqanxhi i dikurshëm.
10. Ferrara regjisori.
12. Kalohet në gjumë.
14. Të parat në sondazh.
15. Është nofka.
16. Një treshe në skenë.
19. Nuk i tregohen babait.
21. Gjysmë tatimi.
23. Berenger aktor.
24. Në mes të një forme.
25. Bëjnë stil të lirë
28. Fillojnë nazet
29. Kalimi në kufij.
30. Një tragjedi... e Dreiser.
33. Grier aktore.
34. Dashi kur mungon ai
36. Është zanore në filma
38. Kufizohet në kufij
39. Ente Civile Europiane.


VERTIKAL

40. Janë galeri në hekurudhë.
41. Ramazzotti këngëtar
42. Mbyllin një tender.
43. Agjenci Formacioni Tiranë.
44. Është pjesë e borxhit që paguhet.
46. Gjysmë tatimi
48. Jessica Parker aktore.
49. Inicialet e Presley.
50. Nuk shuhej dot ngas Tantal.
51. Janë brinjët në skuadër.
52. Qendër fitimi




8. Mbyllin portat.
9. Pak latinisht.
11. Janë zjarrvënës.
13. Qyteti i perjestshëm.
17. Kufizojnë rastet.
18. Shkroi Këngëtarja tullce.
20. Inicialet e Moravia-s.
22. Janë trille.
25. Qytet italian.
26. Jepen për hartim.
27. Fillojë takimet.
29. Kufizojnë kënde.
31. Janë vendet e para.
32. Një greminë.
35. Është logarin që qërohet.
36. Ndiqen me ilace.
37. Massari aktore italiane.
38. Janë kapot.
40. Numri i oktetit.
41. Kush ka... fërgëllon.
44. Një i fundit mbi të gjithë.
45. Një pjesë e satelitëve.
47. Fillojnë tjetrën.
48. Derisa janë në fund.
49. Inicialet e Taylor aktore.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

		7	2					
			4	8	9	2		
		3		9		5		
		1	8	3		4		
9							6	
2	7				6	3		
3		1		5				
		4		9				5
6								7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9


Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	5	3	4	6	8	1	7	9
7	1	4	5	3	9	2	8	6
6	8	9	7	1	2	3	4	5
3	2	5	9	4	6	8	1	7
8	7	6	1	2	5	9	3	4
4	9	1	8	7	3	5	6	2
9	3	8	6	5	4	7	2	1
5	6	7	2	8	1	4	9	3
1	4	2	3	9	7	6	5	8

Argëtim filozofik


- Ato që nuk duhet të bëjnë, nuk duhet as t'i mendojnë.
- Ka kaç shumë njerëz të pangopur, që mendojnë se ata do të jetojnë përgjithmonë. dhe nga ana tjetër ka kaç shumë shpërdorues që mendojnë se ata do të vdesin brënda një momenti.
- Para se të flisni pyesni veten: Ajo që do të them është e sjellshme, është e nevojshme, është e vërtetë, është më mirë se heshtja?

KRIPTOSKEME



KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

M A K U T E R I T T I M
A G A R E N D M T K E
L I T A R E T S O
E M I L E A P E L I M I
E E L E D E P O Z I T A T
A T E K A P A N O N E T
L S E N D A M E A N A
C M I T E E M E R
K O R I T K U K O L L A
U N A Z A R E N D O R E

FJALËKRYQI (2)

M I R A N D A B I S H T I
I K A A R M A D H T D
T O A P A R A T E T A E
I N R D A M A R E T U M A
I R D A M A R E T I L
I A K O T A N I O D
M I N K A B I N E T E R A R
P U R T E K E E T N I K E
P E R S E T I N T I M
L A O I G O L A K
I H R T P E T E R I K
V O L E E L E N D E E

Thënie të mençura

- Në përpjekje për të bërë të tjerët të lumtur, kam harruar veten time !!!
- Ka fjalë që lotojnë dhe lot që flasin ...
- Shiu bie kur retë nuk mund të mbajnë më peshën ..
- Lotët bien kur zemra nuk mund të mbajnë më dhimbjen.
- Gjithkush ka të drejtë të dashurojë personin e gabuar. Në realitet gabimi është të mos e bëjë.
- Jeta është si Facebook-u. Njerëzit i pëlqejnë • problemet tuaja dhe pastaj komentojnë. Por

